



## RAPORT VJETOR PËR VITIN AKADEMIK 2022–2023 UNIVERSITETI “BARLETI”

### I. VLERËSIMI I PËRGJITHSHËM

Ky raport prezanton rezultatet e vitit akademik 2022-2023 të Universitetit “Barleti”. Fokusi i veprimtarisë së institucionit ka vijur të jetë përmbushja e misionit dhe objektivave të tij për përgatitjen e studentëve të një niveli të lartë, profesionistë novatorë, krijues e sipërmarrës, të aftë për sfidat e së tashmes dhe të së ardhmes, si dhe qytetarë të angazhuar të një bote në ndryshim dhe zhvillim të vazhdueshëm. Programet e studimit kanë synuar një ofertë akademike të pasur dhe gjithëpërfshirëse duke krijuar përvojë aktive të studentëve, kërkim shkencor të aplikuar, shërbime me vështrim ndaj biznesit dhe sipërmarrjes, duke rritur ofertën akademike në fushën e shkencave mjeksore, por edhe në fusha të tjera ku aktualisht ofrohen programe. Kjo pasqyrohet në vijim në programet e reja të licensuara gjatë këtij viti akademik.

Veprimtaria e institucionit në këtë vit akademik, mund të vlerësohet e realizuar plotësisht, pasi janë përmbushur objektivat e vendosura. Departamentet u fokusuan për përmirësimin e cilësisë, të ofertës akademike dhe të metodave bashkëkohore të mësimdhënies dhe të nxënies. Të dhënat e rezultateve të arritura nga studentët, tregojnë korrektësinë në vijimësi të zbatimit të procesit akademik.

Gjatë këtij viti institucioni ju nënshtrua kontrollit nga MAS në përputhje me Urdhrin e Ministrit Nr.691 datë 16.11.2022 “Për realizimin e kontrollit të pajtueshmërisë së veprimtarisë së IAL me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi”, dhe jemi në pritje të raportit përfundimtar.

Në vlerësimin e përgjithshëm do të theksonim që Universiteti ka pasur disa arritje dhe zhvillime, si rritjen e ofertës akademike, akreditimin e programeve, ofrimin e një sërë kursesh të kualifikimit të vazhduar, trajnimesh të mësuesve, të specialistëve për vlerësues pasurish, auditues energjistik, të fushës së mjeksisë etj.

Gjatë vitit akademik 2022-2023 UniBa ka ofruar 47 programe, nga të cilat 6 programe dyvjeçare profesionale, 14 Bachelor, 15 Master Profesional, 9 Master i Shkencave dhe tre programe të integruar Master i Shkencave nga të cilat 11 programe u aktivizuan për herë të parë.

Gjatë këtij viti stafi i universitetit bazuar në eksperiencën shumëvjeçare si dhe në studimet e kërkesave të tregut, por edhe nisur nga komentet e marra nga MAS vitin e kaluar për aplikimet për programe të reja u angazhua për të rritur ofertat akademike me synim përafrimin me kërkesat e tregut, duke u mbështetur në studime më të thelluara dhe specifike sipas fushave të interesit. U





morën lejet (Urdhrat e miratimit) për 6 programe të reja; u ndryshuar deri në masën 20% gjashtë programe; Është aplikuar dhe është marrë miratimi për disa kurse të formimit profesional, formimit të vazhduar. I janë nënshtruar procesit të vlerësimit dhe akreditimit 13 programe.

Pas miratimit në vitin e kaluar akademik të fakultetit të katërt (Fakulteti i Shkencave Mjekësore), UniBa miratoi ndryshimin e organigramës, e cila është pjesë e Statutit të UniBa si shtojcë e tij, dhe ndoqi procedurën përkatëse për miratim përfundimtar nga MAS. Ky ndryshim është miratuar me urdhër të Ministrit të MAS nr. 78 datë 09.02.2023 “Për miratimin e një ndryshimi në Statutin e Universitetit “Barleti”.

Gjatë vitit akademik 2022-2023 përveç hartimit dhe miratimit të **rregulloreve** përkatëse për programet e licensuara, janë miratuar disa ndryshime në akte të brendshme: ndryshime në Rregulloren e UniBa që lidhen me frekuentimin, prapen e notës mesatare për të fituar të drejtën e mbrojtjes së diplomës; Ndryshime në *Manualin e hartimit, riorganizimit, mbylljes dhe vlerësimit të programeve të studimit të Kurrikulës*; Ndryshime në Kodin e Etikës.

Rezultatet e vitit akademik 2022-2023 dëshmojnë për një punë të madhe në përmirësimin e cilësisë së programeve e zhvillimin e aktiviteteve ekstrakurikulare. Janë zhvilluar një sërë aktivitete të kërkimore, të cilat paraqiten në seksionin përkatës.

## II. STRUKTURA DHE ORGANIGRAMA E UNIVERSITETIT “BARLETI”

### 2.1 Struktura

Universiteti Barleti është i organizuar në katër fakultete.

Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Industrive Kreative, i cili ka në përbërje tre departamente:

*Departamenti i Shkencave të Aplikuara dhe Kompjuterike*

*Departamenti i Arkitekturës dhe Dizajnit*

*Departamenti i Industrive Kreative*

Fakulteti i Ekonomisë, Qeverisjes dhe Drejtësisë, në përbërje të të cilit janë:

*Departamenti i Drejtësisë*

*Departamenti i Ekonomisë, Sipërmarrjes dhe Financës*

*Departamenti i Qeverisjes, Shkenca Politike dhe Komunikim*

Fakulteti i Shkencave Sociale, Turizmit dhe Sportit, në përbërje të të cilit janë:

*Departamenti i Shkencave të Edukimit dhe Trajnimit Profesional*

*Departamenti i Edukimit Fizik dhe Sporteve*

*Departamenti i Turizmit, Mikpritjes dhe Rekreacionit*

*Departamenti i Shkencave të Sjelljes dhe Shëndetit*

Fakulteti i Shkencave Mjekësore, në përbërje të të cilit janë:

*Departamenti i Shkencave Mjekësore Teknike*






Departamenti i Shkencave Mjekësore dhe të Shëndetit  
Departamenti i Formimit të Përgjithshëm dhe Zhvillimit Profesional

## 2.2 Organigrama

Të gjitha strukturat si ato akademike, kërkimore dhe administrative paraqiten në organigramën e cila është ndërtuar në përputhje me strukturat akademike të miratuara, konkretisht në urdhrin e Ministrisë të MASR Nr. 511 datë 24.10.2019; në dokumentin Miratimi i statusit *Universitet* është bërë me anë të urdhrin të MASR nr.213 datë 03.07.2020 “Për riorganizimin Institucional të Shkollës Universitare Marin Barleti në Universitetin “BARLETI”, dhe Urdhrin e MASR nr.360 datë 23.12.2020 “Për miratimin e statutit të Universitetit “BARLETI”. Sa i takon Fakultetit të Shkencave Mjekësore miratuar me Urdhrin e MAS nr. 117, datë 09.03.2022, dhe pasqyruar në shtojcën e Statutit bazuar në Urdhrin e MAS të cituar më lart.



Adresa:  
Kampali 1, Rruga e Komunistëve,  
N°157, H.I Nr. 3, 1106 Tiranë, Shqipëri  
Kampali 2, Rruga Frang Bardhi, Tiranë  
Call: +355 69 20 62 086 | +355 69 20 41 222 | +355 69 20 67 247  
Email: info@umb.edu.al | matrecratory@umb.edu.al  
admin@umb.edu.al  
Web: www.umb.edu.al



## 2.3 Personeli akademik

### Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Industrive Kreative

#### *Departamenti i Shkencave të Aplikuara dhe Kompjuterike*

Stafi akademik i Departamentit të Shkencave të Aplikuara dhe Kompjuterike gjatë vitit akademik 2022-2023 përbëhet nga 8 anëtare me kohë të plotë dhe 6 me kohë të pjesshme, dhe një staf administrativ (me BA), nga të cilët 1 Prof.dr, 4 PhD/Dr, 10 me MSc.

Misioni i departamentit është të krijojë dhe të zbatojë njohuritë në shkencat e aplikuara dhe kompjuterike, duke përfshirë edhe fushat ndërdisiplinore që shtrijnë këtë fushë në fusha të tjera që janë me përfitim për shoqërinë dhe biznesin; për të edukuar studentët që të jenë të suksesshëm, etik dhe efektiv në zgjidhje të problemeve të ndryshme, të cilët do të kontribuojnë pozitivisht në mirëqenien ekonomike të vendit tonë dhe rajonit dhe të cilët janë të përgatitur për të trajtuar sfidat komplekse të shekullit të ri me të cilat ballafaqohet shoqëria e këtij shekulli. Departamenti ofron programe, kurse, diploma e certifikata që janë konkurese në vend dhe që u mësojnë studentëve se si t'i përdorin teknologjite e reja në mënyrë efektive, kreative dhe inteligjente; që mundësojnë ligjërimit e shkencave të aplikuara dhe kompjuterike si një disiplinë e shumëfishtë, humaniste me qëllim zgjidhjen e problemeve; që ofrojnë kurrikula të azhurnuara në njohuritë teknike dhe shkencore të nevojshme për qëllimet profesionale dhe akademike të studentëve tanë; u mësojnë studentëve se si të fitojnë njohuri të reja, të pavarura, në një botë që ndryshon me shpejtësi gjithnjë në rritje; që u ofrojnë studentëve mundësi të të nxënit eksperimental; dhe që të edukojë një numër në rritje të studentëve në CS për të përmbushur kërkesat në rritje të ekonomisë rajonale dhe vendore.

#### *Departamenti i Arkitekturës dhe Dizajnit*

Stafi akademik i departamentit të Arkitekturës dhe Dizajnit gjatë vitit akademik 2022-2023 përbëhet nga 12 anëtarë nga të cilët 8 anëtarë me kohë të plotë dhe 4 me kohë të pjesshme, 3 PhD, 3 Dr., 6 me MSc.

Filozofia e departamentit bazohet mbi një vizion dhe mision të konsoliduar dhe efikas për përgatitjen e brezave të ardhshme të arkitektëve, ndërtuesve dhe urbanistëve bashkëkohorë. Vizioni i departamentit bazohet në një analizë të të gjithë specifikave profesionale, kërkesave të tregut dhe kërkesave për një zhvillim të qëndrueshëm. Rezultatet e kësaj analize udhëheqin misionin dhe vizionin e departamentit nëpërmjet një edukimi të lartë të integruar dhe multi-disiplinor. Formimi i një arkitekti duhet të përfshijë aftësitë profesionale dhe teknike për të ndjekur në tërësi procesin arkitektonik dhe ndërtimor të një objekti në çdo fazë të tij. Një nga themelet e formimit bazë është njohja e kontekstit në të cilin ai projekton dhe ku integrohet vepra e tij.

Arkitektit, gjatë formimit të tij, i jepen të gjitha mjetet për të lexuar në mënyrë kritike dhe efikase



realitetin në të cilin jetojmë. Njohuritë e përgjithshme dhe specifike për të gjithë elementët e kontekstit urban si trashëgimia kulturore-historike, mjedisi natyror, psikologjik dhe social etj., që ai merr gjatë studimeve ndihmojnë në formimin e tij si arkitekt për të projektuar më vonë mjedise të qëndrueshme.

Departamenti ofron dhe programe të studimeve të formimit të vazhduar të cilat pasqyrohen në seksionin përkatës të programeve.

#### *Departamenti i Industrive Kreative*

Departamenti i Industrive Kreative është njësi që hulumton lidhjen e praktikave krijuese të aplikuara në kontekstet reale të tregut për të krijuar produkte dhe për të ofruar shërbime. Qëllimi i departamentit është krijimi i stimujve, kulturës dhe burimeve të nevojshme për t'i mundësuar studentëve të kthehen në praktikues dhe sipërmarrës të aftë dhe inovatorë në fushën e industrive kreative.

Ky departament aplikoi për dy programe Bachelor studimi, dhe i është miratuar një program, i cili do të fillojë në vitin akademik 2023-2024. Staf i këtij departamenti është i angazhuar në mësimdhënie në programet e tjera të ofruara nga fakulteti dhe për vitin akademik janë angazhuar 7 anëtarë me kohë të plotë nga të cilët 3 PhD/Dr, 3 MsC dhe 1 MP.

#### **Fakulteti i Ekonomisë, Qeverisjes dhe Drejtësisë:**

##### *Departamenti i Drejtësisë*

Gjatë vitit akademik 2022-2023 janë angazhuar pranë këtij fakulteti si staf akademik 19 individë, 8 anëtarë me kohë të plotë; 11 me kohë të pjeshme. Sa i takon gradave dhe titujve: stafi me kohë të plotë 4 Prof.Asoc.Dr., 1 PhD, 4 MsC; Për stafin me kohë të pjeshme 1 Prof.Asoc.dr; 5 Phd/Dr. dhe 5 MsC.

Departamenti i Drejtësisë promovon dhe koordinon kërkime në fushat shkencore juridike duke qenë kështu pika e kontaktit në raport me aktivitetet kërkimore të realizuara nga fusha të përafërta; Këtë vit aktiviteti i departamentit është fokusuar në: Rritjen e standarteve për zhvillimin e programeve mësimore, në funksion të përgatitjes, kualifikimit dhe aftësimin të juristëve të rinj, për ushtrimin e përgjegjësisë dhe kompetencave profesionale.

##### *Departamenti i Ekonomisë, Sipërmarrjes dhe Financës*

Gjatë vitit akademik 2022-2023 është angazhuar si staf me kohë të plotë dhe të pjeshme 30 individë, nga të cilët 11 anëtarë me kohë të plotë; 19 me kohë të pjeshme. Sa i takon gradave dhe titujve: 2 prof.Dr., 3 Prof.Asoc.Dr., 15 Dr., 13 MSc.

Departamenti i Ekonomisë, Sipërmarrjes dhe Financës kryen një gamë të gjerë të aktiviteteve mësimore në fushat e përgjithshme të ekonomisë, sipërmarrjes dhe financave, përmes ofrimit të një sërë diplomash në fushën e financës, kontabilitetit, sistemit bankar, pasurive të paluajtshme,





menaxhimit dhe marketingut. Përmes programeve të tij të studimit, ky departament ofron baza të forta teorike dhe metodologjike për të zhvilluar dije themelore për të kuptuar thellësisht strukturën ekonomike.

### *Departamenti i Qeverisjes, Shkenca Politike dhe Komunikim*

Stafi akademik i angazhuar për zhvillimin e programeve mësimore për vitin akademik 2022-2023 është përbërë nga nga 7 anëtarë me kohë të plotë, dhe një me kohë të pjeshme ku 2 Prof.Asoc.dr., 1 Dr/PhD, 4 MSc dhe stafi me kohë të pjeshme 3 PhD/Dr. Dhe 2 MsC.

Departamenti i Qeverisjes, Shkenca Politike dhe Komunikim nëpërmjet programeve të studimit synon përgatitjen e profesionistëve të rinj me njohuri teorike dhe praktike dhe aftësi aplikative në fushën e qeverisjes, politikës, komunikimit, vendimmarrjes duke zhvilluar ndër të tjera mendimin analitik dhe kritik ndaj tyre. Politika, në të gjithë format e saj, ka qenë dhe mbetet kryefjalë e vazhdueshme e artikulimit dhe funksionimit të shoqërisë, e cila e ka përdorur politikën si instrument për të administruar pushtetin dhe për të mundësuar pjesëmarrjen.

### **Fakulteti i Shkencave Sociale, Turizmit dhe Sportit**

#### *Departamenti i Shkencave të Edukimit dhe Trajnimit Profesional*

Stafi akademik i angazhuar për zhvillimin e programeve mësimore përbëhet nga 7 anëtarë me kohë të plotë, dhe 3 me kohë të pjeshme ku 2 Prof.Asoc.dr., 4 Dr, 1 Phd, 4 MSc.

Departamenti Shkencave të Edukimit dhe Trajnimit Profesional ofron dhe koordinon programe e kërkime në fushat e edukimit; zbaton e monitoron programe profesionale në bashkëpunim të ngushtë me departamentet përkatëse të universitetit, të cilat mbulojnë procesin e tyre, akademik; menaxhon studime master, në fushën e mësimdhënies dhe të nxënit, program për formimin e drejtuesve të ardhshëm të institucioneve arsimore, por dhe kualifikime të vijueshme për mësues, drejtues të edukimit, për tematika që lidhen me nevojat e arsimit parauniversitar. Këtë vit akademik krahas masterit profesional në “Edukim”, me profil “Mësimdhënie dhe të nxënit” ofroi për herë të parë “Master Profesional” në “Arsim Special”; “Master Profesional” në “Mësuesi në Arte”; “Master Profesional” në “Mësuesi në gjuhë dhe komunikim”; “Master Profesional” në “Mësuesi në Teknologji Informacioni dhe Komunikimi (TIK)”; “Master Profesional” në “Mësuesi në Shkenca Sociale”.

Departamenti ka zbatuar për herë të katërt, gjatë këtij viti, programin e shkollës së drejtorëve përgjatë një viti akademik. UniBa është i vetmi institucion jopublik që ka fituar të drejtën e zbatimit të këtij programi, nëpërmjet një konkurimi të hapur nga Fondacioni Amerikano-Shqiptar i Zhvillimit (AADF). Me një ekip pedagogësh/trajnerë prej 12 vetësh (7 të brendshëm dhe 5 të jashtëm), si dhe me dy grupe pjesëmarrësish prej 52 aspirantësh për drejtues, u arrit që të zbatohet me sukses ky program gjatë vitit akademik 2022-2023, sepse krahasuar me ofruesit e tjerë/ 3 universitete publike, jemi më mirë me arritjet dhe certifikimin e pjesëmarrësve tanë nga testimi i QSHA. 1 nga vendet e para e para të më të mirëve, nga të katër universitetet ofruese të





programit, është nga UniBa, i cili ka fituar të drejtën për një trajnim në Universitetin e Harvardit-Shkolla e Lidershipit.

Këtë vit akademik departamenti licensoi programin e vazhduar Psiko-Pedagogjik 4,5 mujor, që vlen për të gjithë ata që kanë studime master shkencor që lidhen me fushat e mësuesisë, por që nuk janë mësues. Në mbështetje të ligjit nr. 80 datë 17.09.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, neni 81 i këtij ligji, pikat 1, 2, 3 që lejon institucionet e arsimit të lartë për të zhvilluar programe të formimit të vazhduar, si dhe të Udhëzimit Nr. 3, datë 15.02.2023 i MAS “Për përcaktimin e diplomave universitare të një vlershme, të Ngjashme ose të Përafërta me Fushën/Lëndët e Mësimdhënies në Arsimin Parauniversitar dhe Kriteret për Hapjen e Programeve të Studimeve të Formimit të Vazhduar në Fushën Psiko-Pedagogjike”. Ky program 4,5 mujor do të zbatohet nga Departamenti gjatë vitit akademik 2023-2024.

#### *Departamenti i Edukimit Fizik dhe Sporteve*

Stafi akademik i angazhuar për zhvillimin e programeve mësimore përbëhet nga 15 anëtarë me kohë të plotë, dhe 16 me kohë të pjeshme ku 2 Prof.Dr, 2 Prof.Asoc.dr., 5 Dr, 22 MSc.

Departamenti i Edukimit Fizik dhe Sporteve ka si vizion të përgjithshëm të përgatisë specialistë të lartë të Edukimit Fizik e Sportit, të kompletuar me njohuri dhe shprehje moderne profesionale, të aftë për të përballuar dhe fituar sfidat aktuale dhe të perspektivës të profesionit të mësuesit të Edukimit Fizik, trajnerit të sportit, instruktorit të fitnesit dhe rekreacionit, në Shqipëri dhe jashtë saj.

#### *Departamenti i Turizmit, Mikpritjes dhe Rekreacionit*

Stafi akademik i angazhuar për zhvillimin e programeve mësimore përbëhet nga 7 anëtarë me kohë të plotë, ku 1 Prof.Asoc.dr., 3 Dr, 1 Phd , 3 MSc.

Vizioni i departamentit është krijimi i një departamenti multifunksional, aplikativ dhe novator, ku janë të ndërthurura teoria dhe praktika me kërkimin shkencor dhe trajnimet e vazhdueshme për shërbimet në industrinë e turizmit dhe sektorët ndërlidhur me të. Ka ofruar dhe ka implementuar dy programe studimi që janë aktive, konkretisht “Bachelor” në “Menaxhim në Turizëm, Rekreacion dhe Evente”, dhe “Master Profesional” në “Menaxhim në Turizëm, Mikpritje dhe Aktivitete Çlodhëse”.

#### *Departamenti i Shkencave të Sjelljes dhe Shëndetit*

Stafi akademik i angazhuar për zhvillimin e programeve mësimore përbëhet nga 7 anëtarë me kohë të plotë, dhe 15 me kohë të pjeshme ku 13 Dr/PhD, 9 MSc.

Departamenti i Shkencave të Sjelljes dhe Shëndetit ka si mision përcjelljen e dijeve dhe aftësimin praktik të studentëve në funksion të rritjes së mirëqënies bio-psiko-sociale të individit. Programet e studimit i përgjigjen plotësisht nevojave të tregut, duke formuar profesionistë të





shëndetit mendor, përkujdesjes sociale dhe kujdesit shëndetësor, të cilët janë plotësisht të aftë për tu përballur me sfidat e profesionit.

### **Fakulteti i Shkencave Mjekësore**

#### *Departamenti i Shkencave Mjekësore dhe të Shëndetit*

Departamenti ka në përbërjen e tij 7 anëtarë me kohë të plotë, nga të cilët 2 të kategorisë Prof.asoc.Dr., 3 Dr/PhD, dhe 2 Msc.

#### *Departamenti i Shkencave Mjekësore Teknike*

Departamenti ka në përbërjen e tij 7 anëtarë me kohë të plotë dhe 11 anëtarë me kohë të pjeshme, nga të cilët 3 të kategorisë Prof.Dr, 3 Prof.Asoc.Dr, 3 Dr, dhe 9 me Msc.

#### *Departamenti i Formimit të Përgjithshëm dhe Zhvillimit Profesional*

Departamenti ka në përbërjen e tij 7 anëtarë me kohë të plotë dhe 3 me kohë të pjeshme, nga të cilët 1 të kategorisë Prof.Dr, 2 Dr, dhe 4 me Msc.

Struktura akademike për vitin 2023-2024 pasqyrohet në Aneks1<sup>1</sup>.

### **2.4. Parashikimi i ngarkesës për vitin akademik 2023-2024**

Për hartimin e ngarkesën Rektori miraton udhëzimin përkatëse duke konsideruar angazhimin e stafit në punë administrative, projekte kërkimore. Parashikimi i ngarkesës për vitin akademik 2023-2024 paraqitet në **Aneks 1: Struktura akademike dhe draft ngarkesa për vitin akademik 2022-2023 për stafin akademik me kohë të plotë.**

Momentalisht është draft pasi do të rishikohet në varësi të regjistrimeve të reja, veçanërisht në programet e studimit master, si dhe për stafin me kohë të pjeshme.

## **III. MËSIMDHËNIA**

### **3.1. Objektivat e mësimdhënies**

UniBa ofron programe studimesh në përputhje me kërkesat e MAS, me legjislacionin shqiptar, me Statutin dhe Rregulloren e Institucionit. Institucioni. UniBa, ofron programe me karakter profesional; programe të ciklit të parë të studimeve; programe të ciklit të dytë të studimeve në përputhje me përcaktimet e legjislacionit në fuqi për arsimin e lartë.

Programet me karakter profesional, synojnë të japin njohuri të konsoliduara profesionale dhe aftësi praktike përkatëse. Programet e studimit të ciklit të parë synojnë t'i pajisin studentët me njohuritë, aftësitë, qëndrimet themelore mbi metoda dhe parime të përgjithshme, shkencore dhe aftësi specifike për larmi profesionale. Programet e studimit të ciklit të dytë synojnë thellimin e njohurive teorike dhe praktike të studentëve dhe ofrojnë studime të avancuara dhe kërkim

<sup>1</sup> Mbetet draft pasi akoma nuk ka përfunduar procesi i rekrutimit.







shkencor. Institucioni ofron program të integruar në Arkitekturë, me kohëzgjatje 5-vjeçare si dhe program të integruar në Drejtësi, me kohëzgjatje 5-vjeçare.

Pavarësisht se në cilin cikël ofrohen programet, apo në cilën fushë objektivat e mësimdhënies kanë synuar rritjen e nivelit të saj, rritjen e rezultateve të të nxënit, përmirësimin e metodave të mësimdhënies, integritit e njohurive teorike me ato praktike.

UniBa ka politika të vlerësimit që ndihmojnë përmirësimin e programeve të studimit. Departamentet në bashkëpunim me Njësinë e Zhvillimit të Kurrikulave dhe Cilësisë (NJZHK) realizojnë vlerësimin e studentëve për lëndët/ modulet dhe përpunojnë të dhënat përkatëse. Njësia e Zhvillimit Kurrikular dhe Cilësisë (NJZHKC) si njësi autonome në nivel institucioni që ka për objekt të veprimtarive të saj monitorimin, vlerësimin, zhvillimin e përmirësimin e cilësisë së veprimtarisë akademike së UniBa-s dhe të strukturave administrative në shërbim të rritjes e përmirësimit të vazhdueshëm të cilësisë. Strukturë tjetër bashkëpunuese në nivel institucioni është Komisioni i Sigurimit të Standardeve të Cilësisë si organ kolegjal i përhershëm i cili siguron orientim, këshillim dhe mbështetje në hartimin e politikave dhe procedurave të sigurimit të brendshëm të cilësisë. Detyrat dhe përgjegjësitë e tyre detajohen në rregulloret përkatëse të funksionimit të tyre.

Një nga objektivat në këto është zbatimi i politikave të krijimit e forcimit të kulturës së brendshme të cilësisë për të cilën janë organizuar veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programeve të studimit si dhe për tërheqjen e mendimeve të tyre rreth mësimdhënies dhe cilësisë së saj. Partnerët kryesorë bashkëpunues në këto veprimtari janë njësitë bazë të Universitetit. Ndër instrumentet që ka përdorur NJZHKC për fotografimin e gjendjes së cilësisë janë:

- ✓ Vlerësimi i studentëve për lëndën, përmes formularëve përkatës,
- ✓ Vlerësimi i mësimdhënies kolegë me kolegë (*peer to peer*) përmes shpërndarjes së formularëve,
- ✓ Raport mbi transparencën dhe krahasueshmërinë e vlerësimit mbas shpërndarjes së formularëve përkatës.

Rezultatet janë transparente. Rezultatet pasqyrohen dhe në raportet e vlerësimit. UniBa përdor procedura dhe instrumente vlerësimi dhe monitorimi të procesit të mësimdhënies: vlerësim nga studentët; pyetësorë; fokus grupe; analiza të rezultateve të studentëve në provime, detyra kursi, projekte; vëzhgime gjatë kryerjes së praktikës; rezultate të detyrimeve përmbyllëse, etj. Raportet e hartuara në këto raste kanë shërbyer hartimit të planeve të masave, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara. Një strukturë me të cilën ka bashkëpunuar ngushtë gjatë kësaj periudhe është Koordinatorin i Menaxhimit të Performancës. Viti akademik 2022-2023 ka përkuar dhe me vlerësimin e brendshëm dhe të jashtëm për akreditimin e 13 programeve të studimit.





### 3.2. Të dhëna mbi programet e studimit të UniBa

**3.2.1. Programet e studimit që ofron UniBa** (*Informacion mbi të gjithat e programeve të studimit që ofron universiteti, përfshirë ato ndërdisiplinore dhe të përbashkëta, nëse ka; programet e studimit që janë aktive, të pezulluara, të mbyllura, për të cilën/cilat është marrë leje për hapjen e tij/tyre, por nuk është aktivizuar*)

#### 3.2.1.1. Programet aktive gjatë vitit akademik 2022-2023

Gjatë vitit akademik 2022-2023 UniBa ka ofruar në total 47 programe<sup>2</sup> dhe më konkretisht (*Aneks2: Programet aktive për vitin 2022-2023*):

- 6 “Diplomë profesionale”,
- 14 “Bachelor”,
- 15 “Master profesional”.
- 9 “Master i shkencave”,
- 3 “Master i shkencave” program i integruar,

Programet e studimit të cilët u aktivizuan për herë të parë në vijim të licencimit të tyre:

“Bachelor” në “Fizioterapi” - UMAS Nr. 388, datë 08.07.2022;

“Bachelor” në “Infermieri” - UMAS Nr. 389, datë 08.07.2022;

“Master profesional” në “Mësuesi në shoqëria dhe mjedisi” - UMAS nr. 485, datë 30.08.2022;

“Master profesional” në “Mësuesi në arte” - UMAS nr. 505, datë 06.09.2022;

“Master profesional” në “Mësuesi në Teknologji Informacioni dhe Komunikimi” - UMAS nr. 506, datë 06.09.2022;

“Master profesional” në “Arsim special” - UMAS nr. 508, datë 06.09.2022;

“Master profesional” në “Mësuesi në Gjuhë dhe Komunikim” - UMAS nr. 587, datë 04.10.2022;

“Master profesional” në “Mësuesi në shkencë sociale” - UMAS nr. 588, datë 04.10.2022;

“Master i shkencave” në “Psikologji klinike” - UMAS nr. 507, datë 06.09.2022;

“Master i shkencave” në “Puna sociale në Sistemin Arsimor” - UMAS nr. 486, datë 30.08.2022;

“Master i shkencave” i integruar, në “Farmaci” - UMAS nr. 460, datë 27.07.2022;

#### 3.2.1.2. Hapje programe të reja (licensime), riorganizime deri në masën 20%, akreditime

##### a) Hapja e programeve të reja të studimit:

Gjatë vitit akademik 2022-2023 UniBa ka aplikuar për licensimin e 11 programeve të reja, nga të cilat 5 janë refuzuar: 6 programe “Bachelor”, 3 programe “Master profesional” me 120 ECTS, 1 program studimi “Master i shkencave” dhe 1 program i integruar të ciklit të dytë të studimeve, si më poshtë:

“Bachelor” në “Arte digjitale në industrinë kreative”;

“Bachelor” në “Dizajn interieri dhe produkti”;

<sup>2</sup> Programet që kanë profile, secili profil është llogaritur si një program studimi nisur nga diploma që lëshohet në fund.





“Bachelor” në “Shkenca kompjuterike”;  
“Bachelor” në “Inxhinieri elektronike dhe kompjuterike”;  
“Bachelor” në “Aktivitet fizik, shëndet dhe dietologji”;  
“Bachelor” në “Mësuesi në Edukim Fizik dhe Sporte”, në bashkëpunim me UGJ  
“Master Profesional” në “Komunikim Digjital”;  
“Master Profesional” në “Infermieri në familje dhe komunitet”;  
“Master Profesional” në “Dietologji dhe nutricion”;  
“Master i shkencave” në “Menaxhim, financim dhe politika shëndetësore”;  
“Master i shkencave” (integ) në “Stomatologji”

**Nga të cilët u licencuan:**

“Bachelor” në “Dizajn interieri dhe produkti”;  
“Bachelor” në “Shkenca kompjuterike”;  
“Bachelor” në “Aktivitet fizik, shëndet dhe dietologji”;  
“Master Profesional” në “Infermieri në familje dhe komunitet”;  
“Master i shkencave” në “Menaxhim, financim dhe politika shëndetësore”;  
Program i Interguar “Master i shkencave” në “Stomatologji”

**b) Riorganizime programesh studimi deri në 20% të përmbajtjes.**

Bazuar edhe në rekomandimet e Bordit të Akreditimit, gjatë vitit akademik 2022 – 2023 departamentet rishqyrtuan programet e ofruara dhe propozuan riorganizimin e disa programeve, duke ndryshuar përmbajtjen e tyre deri në masën 20% të ECTS-ve, sipas vendimeve të Senatit Akademik:

Program profesional në “Teknik në operacione biznesi, marketing dhe shitje” – Vendimi i Senatit nr. 15, datë 28.03.2023;

Program profesional në “Teknik në prodhime digjitale dhe zhvillim softëare” – Vendimi i Senatit nr. 12, datë 28.03.2023;

Program profesional në “Operator dhe këshillues në përkujdesje shëndetësore” – Vendimi i Senatit nr. 10, datë 28.03.2023;

“Bachelor” në Informatikë e aplikuar” – Vendimi i Senatit nr. 13, datë 28.03.2023;

“Bachelor” në “Menaxhim në turizëm, rekreacion dhe evente” – Vendimi i Senatit nr. 14, datë 28.03.2023;

“Master i shkencave” në “Mësuesi në edukim fizik dhe sporte” – Vendimi i Senatit nr. 10, datë 28.03.2023;

**Miratimi i tyre nga Ministria e Arsimit dhe Sportit u njoftua përmes shkresës nr 2173/1, datë 28.04.2023.**

**c) Zgjerimi i ofertës akademike**

Në përputhje me misionin dhe objektivat e tij, të përcaktuar në Statutin dhe dokumentin e tij strategjik, UniBa nxit frymën e formimit të vazhdueshëm. Në këtë veprimtari UniBa, bazuar në



analizat e kërkesave të tregut të punës, harton dhe përdor metoda e module që synojnë zhvillimin e mëtejshëm individual të pjesëmarrësve duke mos u shkëputur nga angazhimet e punës së tyre. Në këtë kuadër ofrohen edhe programe të studimeve të formimit të vazhduar, formime afatshkurtra si kualifikime profesionale dhe specializime të ndryshme. Grupi Barleti ka ngritur një strukturë që ofron trajnime kualifikuese në frymën e të nxënësve gjatë gjithë jetës, Qendra e Trajnimeve dhe Testimit “Barleti”. Kjo strukturë bashkëpunon ngushtë me njësitë bazë dhe kryesore për të ofruar trajnime dhe programe kualifikuese për studentët e “Bachelor”-it dhe “Master”-it, por edhe profesionistë të tjerë në tregun e punës në një gamë të gjerë kursesh profesionale. Në përfundim të këtyre programeve, lëshohen certifikatat përkatëse, të njohura në tregun e punës.

Gjatë vitit akademik 2022–2023 nga ana e UniBa-së janë aplikuar dhe miratuar disa kurse të formimit profesional. Miratimi i tyre bëhet nga Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

Kurset e miratuar dhe kohëzgjatja (afati i maturimit) e tyre

- Mbi Mekatronikën - 10 muaj
- Siguria dhe mbrojtja e shëndetit në punë - 6 muaj
- Mbrojtja e shëndetit dhe siguria në punë - 1 muaj
- Teknik i gazrave të florinuara dhe substancave ozonholluese - 2 muaj
- Përkujdsje ndaj të moshuarve - 3 muaj
- Formim i agjentëve të tokenit digjital - 3 muaj
- Krijimi, financimi dhe menaxhimi i një OJF-je - 1 muaj
- Teknika e vjeljes së taksave dhe borxhit - 1 muaj
- Konkencionet dhe huamarrjet - 1 muaj
- Prokurimet publike - 1 muaj
- Shkrimi dhe aplikimi i projekteve evropiane dhe ndërkombëtare - 1 muaj

Në të njëjtën periudhë është aplikuar për akreditim të aktiviteteve të edukimit të vazhduar për profesionistët e shëndetësisë të miratuar nga Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Kujdesit Shëndetësor dhe Shoqëror. Në kuadrin e veprimtarive formuese të tyre janë zhvilluar kurse për:

- Lazeri dhe përdorimi në dentistrinë
- Kurs trajnimi mbi kontrollin gjithëpërfshirës të kancerit të qafës së mitrës
- Fibroza kistike. Rehabilitimi respirator
- Asistenca infermierore perioperatore
- Rehabilitimi neurokonjektiv në pacientët hemiplegjikë
- Yoga terapeutike për fëmijët me nevoja të vecanta dhe sfida zhvillimi
- Kursi i trajnimit në dhënien e ndihmës së parë-CPR

Trajnimet e zhvilluara nga Fakulteti i Shkencave Mjekësore për periudhën: Nëntor 2022-Qershor 2023 kanë konsistuar në:

- Yoga terapeutike për fëmijët me nevoja të veçanta dhe sfida zhvillimi 17-18 Dhjetor 2022
- Rehabilitimi Neurokonjitiv në Pacientët Hemiplegjikë, 21-22 Janar 2023
- Asistenca Infermiore Perioperatore, 11 Mars 2023
- Asistenca Infermiore perioperatore, 8 Prill 2023
- Fibroza Kistike dhe rehabilitimi respirator, 1 Prill 2023
- Dhënia e ndihmës së parë- CPR, 14-15 Prill 2023
- Dhënia e ndihmës së parë, 30 Prill- 1 Maj 2023
- Dhënia e ndihmës së parë, 27-28 Maj 2023
- Dhënia e ndihmës së parë, 10- 12 Qershor 2023

**3.2.3. Studimi i tregut të punës** (*Informacion mbi përshtatshmërinë e programeve të studimit me misionin e institucionit, realizimin e synimeve të programit të studimit nga ana e përmbajtjes dhe lidhjen e rëndësishme të programeve të studimit nisur nga vlerësimi i nevojave për aftësi në tregun e punës*).

Njësitë bazë dhe kryesore në UniBa në bashkëpunim me strukturat mbështetëse kanë intensifikuar dhe ri-dimensionuar veprimtaritë lidhur me studimin e tregut të punës për identifikimin e nevojave që ekzistojnë për profesionistë, dinamikën e ndryshimit të tyre, si dhe aftësitë që ata duhet të kenë. Mes këtyre nismave përmendim si më poshtë.

Për të gjitha programet që synojmë të licencohen, njësia bazë bën një kërkim të thelluar të tregut të punës i cili është pjesë e dosjes së aplikimit për hapjen e programeve të reja, riorganizimin e atyre ekzistues por edhe të përditësimit të informacionit të dhënë në auditor. Nga studimi i tregut të punës realizuar nga njësitë bazë rezultojnë se ka një nevojë në treg për specialistë në fushën e shëndetësisë (sidomos për infermirë të profilizuar në terapi intesive dhe urgjencë, menaxhim infermior dhe infermiere të profilizuar për shërbime në familje e komunitet, etj), në fushën e industrisë kreative dhe informatikës. Mbështetur në gjetjet nga këto studime njësitë bazë kanë projektuar hapjen e programeve të reja në fushat e sipër cituara, për të cilat u bënë dhe aplikimet përkatëse, të dhënat e të cilave janë parashktruar më lart..

Një rol të rëndësishëm luajnë angazhimet që rrjedhin nga marrëveshjet e shumta që janë arritur me partnerë të ndryshëm, prej të cilëve kërkohet përgjigje adekuate dhe reflektim të kërkesave të tregut gjatë procesit të mësimdhënies. Nënvizojmë dhe përvojat e fituara gjatë vizitave të realizuara në kuadrin e programit ERASMUS+ ku stafit akademik i kërkohet, veç të tjerave, të prezantojë risitë si rezultat i vizitave.

Nisur nga informacioni i mbledhur vazhdimisht njësitë përmirësojnë programet e tyre të studimit duke i riorganizuar si në përmbajtje dhe metodologji edhe në ndryshime profilizuese në ndryshim lëndësh dhe peshë kreditesh.

Procesi i riorganizimit të programeve ekzistuese dhe hapjes së programeve të reja koordinohet në nivel institucional nga njësi e zhvillimit kurrikular dhe cilësisë. Kjo njësi ka hartuar procedura standarde në përputhje me kërkesat ligjore në fuqi për të dy këto procese themelore. Ajo organizon dhe takime me stafet e departamenteve gjatë të cilëve shkëmbehen mendime dhe gjetjet e eksperiencave më të mira.

Në të gjitha aplikimet e bëra si për hapjen e programeve të reja, edhe për ndryshimin deri në masën 20% janë prezantuar si pjesë e dokumentacionit përkatës edhe studimet e tregut, gjetjet përkatëse.

*Lista e programeve jo aktive, Programeve dhe profileve për t'u mbyllur, programe për të cilat është kërkuar leja për hapje gjatë vitit akademik 2022-2023 dhe statusi përkatës paraqiten respektivisht në Aneks 3, Aneks 4, Aneks 5.*

### **3.3. Bashkëpunime ndërinstytucionale**

Bashkëpunimi në nivel kombëtar, rajonal dhe ndërkombëtar është pjesë e rëndësishme e strategjisë së UniBa, e shprehur edhe në vizionin e UniBa. UniBa ka një rrjet bashkëpunëtorësh në nivel kombëtar dhe rajonal dhe ka një larmi aktiviteteve si: konferenca, workshope, takime informuese, projekte, por edhe aktivitete komunitare, realizimin e praktikave dhe intershipeve të studentëve etj., të cilat nuk kanë munguar edhe këtë vit akademik. Mes tyre përmendim institucione publike në nivel kombëtar dhe lokal, organizata jofitimprurëse, organizata të biznesit, ambasada dhe përfaqësi të huaja, universitete publike dhe private etj. Gjithashtu UniBa ka dhe një rrjet bashkëpunëtorësh në nivel ndërkombëtar. Produkt i këtyre marrëveshjeve kanë qenë në bashkëpunime në projekte, programe të përbashkëta studimi, shkëmbim pedagogësh, trajnime, konferenca.

Gjatë vitit akademik 2022-2023 janë nënshkruar 47 marrëveshje bashkëpunimi, nga të cilat 4 janë me universitete/kolegje, ndërsa marrëveshjet e tjera me partnerë të ndryshëm në funksion të ofertës akademike, si me institucione të ndryshme brenda vendit, biznese, agjenci, studio të ndryshme. Për marrëveshjet e nënshkruara gjatë dy viteve të fundit referojuni ***Aneks 6: Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit të nënshkruara gjatë vitit akademik 2022-2023.***

Ky zgjerim i rrjetit të partnerëve pasuron edhe tërësinë e shërbimeve të ofruara ndaj studentëve, si të ftuar personalitete të fushave të ndryshme në UniBa, për aktivitete informuese & zhvilluese, orientim karriere, aktivitete komunitare, bamirëse dhe kulturore, si dhe për praktikant profesionalë të studentëve, punë vullnetare në komunitet, vizita studimore etj.

Në kuadër të marrëveshjeve të Erasmus+, është mundësuar mobiliteti i 19 grupeve/ 52 anëtarë të stafit të UniBa dhe 11 grupe/23 individë që janë mirëpritur nga universitetet partnere. Lista e tyre paraqitet në ***Aneks 7: Mobiliteti i stafit nga dhe në UniBa 2022-2023***



Nëpërmjet zyrës së alumnit dhe karrierës por edhe njërive bazë ruhet bashkëpunim i ngushtë me tregun e punës në mënyrë të veçantë me agjencitë e rekrutimit dhe punësimit me qëllim integrimin e të diplomuarve në tregun e punës. Këto aktivitete pasqyrohen dhe në [www.umb.edu.al](http://www.umb.edu.al).



## IV. VEPRIMTARIA KËRKIMORE-SHKENCORE e UniBa

### 4.1. Përmbledhje

Në aktivitetin e tij kërkimor, UniBa mbështetet në përfaqshen, modelin e helikës së pesëfishtë sipas së cilit aktorët bashkëveprues janë pesë: Akademi dhe Institute, Industri dhe Sipërmarrje, Qytetar dhe Përdorues (konsumator), Qeveri - Institucione Ndërkombëtare, Ambienti dhe Ekosistemi.

Vizioni i UniBa-s është jo vetëm të ofrojë dije të avancuara dhe edukojë studentët në fusha të ndryshme profesionale, por të jetë lider në botën e arsimit të lartë, një universitet aplikativ që kultivon sipërmarrjen, duke kontribuar në zhvillim, rritje e novacion nëpërmjet mbujtes së lidhshpimit dhe talentëve sipërmarrëse dhe kërkim e inovacion edhe në zgjidhjen e problemeve të ditës.

Ekosistemi sipërmarrës është në bazë të programeve të kërkimit në përgjithësi dhe atij të aplikuar në veçanti, si dhe të novacionit të hapur ku UniBa mbështet zhvillimin e tij si universitet aplikativ. Si i tillë, UniBa zhvillon dhe mbështet programe bashkëkohore të niveleve të ndryshme përfshirë dhe ato profesionale, që edukojnë aftësi e cilësi sipërmarrëse, që mbështesin bizneset dhe individët në sipërmarrje private apo profesionale, që përgatisin jo vetëm specialistë por krijues e drejtues biznesesh, lojtarë aktivë në zhvillimet shoqërore e ekonomike të vendit e më përtej.

### 4.2. Strategjia

Për të realizuar vizionin e tij, UniBa synon të bëhet një institucion aplikativ, novator dhe lider, ndërveprues dhe komunitar, i orientuar nga tregu i punës dhe kërkesat e zhvillimit krijues të qëndrueshëm, duke vendosur studentin në qendër dhe duke zhvilluar bashkëpunime rajonale dhe ndërkombëtare.

UniBa ka për qëllim të realizojë projekte të ndryshme zhvillimi, të cilat mund të fokusohen në ndërtim, rikonstruksion apo pajisje të infrastrukturës së nevojshme, laboratorëve, auditorëve apo godinave dhe territoreve të caktuara në shërbim të procesit akademik, rekreacionit, aktivitetit sportiv apo të jetës së studentëve, stafit dhe qytetit ku zhvillojnë aktivitetin.

### 4.3. Kërkimi shkencor dhe i aplikuar në UniBa gjatë 2022-2023

Raporti i kërkimit shkencor dhe kërkimit të aplikuar në Universitetin “Barleti” për vitin akademik 2022-2023 përfshin evidenca rreth ngritjes së kapacitetit në shërbim të Kërkimit Shkencor dhe Kërkimit të Aplikuar.

Gjatë 2022-2023 UniBa ka bërë hapa drejt realizimit të vizionit të Universitetit “Barleti” si Universitet Aplikativ.





Në këtë vit Universiteti “Barleti” u shpall fitues i tre projekteve të thirrjeve të AKKSHI, si më poshtë:

1. Dy projekte të kërkimit dhe zhvillimit (PKKZH) të cilat fokusohen në:
  - fushën e biodiversitetit e mjedisit, që do të udhëhiqet nga departamenti i Arkitekturës dhe Dizanjit, me titull “Qytetet Nëntokësore në Shqipëri”.
  - shëndetësisë e shkencave mjekësore, që do të udhëhiqet nga Departamenti i Shkencave Mjekësore dhe të Shëndetit, me titull “Shkallët e vlerësimit të gjëndjes në individët e moshës së tretë: Vlera dhe Implementimi i tyre”.
2. Një projekt i kërkimit shkencor që do zhvillohet si partneritet i Universitetit “Barleti” me biznesin FIX PRO sh.p.k, në fushën prioritare Uji dhe Energjia, dhe do të udhëhiqet nga departamenti i Shkencave të aplikuara dhe kompjuterike, me titull “Optimizimi dhe rritja e produktivitetit me anë të masave të efencës së energjisë në godinat dhe linjat e prodhimit të kompanisë FIX Pro sh.p.k”.

Gjithashu gjatë këtij viti akademik UniBa nënshkroi marrëveshje bashkëpunimi me Albanian American Development Fund (AADF), për pjesëmarrje në Programin: *Research Expertise from the Academic Diaspora (READ)*.

Pas zbatimit për dy vitet e para në universitetet publike, programi READ do të zgjerohet edhe në pesë universitete private: Universiteti “Barleti”, UET, Epoka, NY Tirana dhe POLIS, duke vlerësuar kështu potencialin e IAL-ve jopublike në realizimin e projekteve kërkimore shkencore cilësore dhe botimin e artikujve në revista të njohura ndërkombëtare në bashkëpunim me akademikët e diasporës shqiptare.

Programi READ, do të krijojë mundësinë e bashkëpunimit të akademikëve tanë në diasporë me akademikët dhe kërkuesit shkencor të UniBa, në projekte komplekse dhe me peshë për ngritjen e projekteve brenda Shqipërisë në nivelin e universiteteve europiane dhe botërore.

Por nga ana tjetër përpjekjet e Barletit për ngjitje të nivelit të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor janë të shumta, si ftesa në leksionin e hapur “E ardhmja e Gjuhës Angleze në Mësimdhënien Bashkohore”, të Drejtoreshës për Evropën të British Council Znj. Joanna Burke organizuar nga Departamenti i Shkencave të Edukimit dhe Trajnimit Profesional dhe Barleti Professional në kuadër të bashkëpunimit APTIS.

Departamentet, Fakultetet, Institutet dhe njësitë e tjera të UniBa-s veprojnë si hallka të një zinxhiri vlere krijues jo vetëm dijesh aktive por dhe aftësish krijuese në shërbim të shoqërisë, ekonomisë, qeverisjes e shkencës.

Në shërbim të çështjes së qëndrueshmërisë mjedisore **Bashkia Tiranë**, në bashkëpunim me **ICTSlab**, solli për herë të parë në Shqipëri, **Climathon Tirana** është një katalizator zgjidhjesh për sfidat klimatike të kryeqytetit Shqiptar por edhe i startupeve të së nesërme. Komisioni





Evropian në përgjigje të numrit në rritje të qytetarëve në mbarë botën që dëshirojnë të bëhen pjesë e lëvizjeve që duan të bëjnë ndryshimin, ka krijuar, **EIT Climate-KIC** një platformë për qytetarët dhe vendimmarrësit të cilët së bashku mund të krijojnë një të ardhme më të mirë. Misioni i Climathon është të fuqizojë njerëzit të cilët duan të ndryshojnë vendet dhe komunitetet dhe është një mundësi e artë për zhvillimin e ideve sipërmarrëse të qëndrueshme. Staf i UniBa-s u bë pjesë e këtij eventi tre ditor në rolin e mentorëve dhe aktiviteti u zhvillua në mjediset e universitetit duke vënë theksin mbi karakterin dhe vizionin e UniBa në të funksionuarit si një universitet aplikativ.

Çështja e qëndrueshmërisë mjedisore është edhe ekspertizë e një pjese të stafit të UniBa, dhe kjo tregohet edhe në publikimet e tyre, si:

Artikulli: *Get Rid of Marine Pollution: Bioremediation an Innovative, Attractive, and Successful Cleaning Strategy* Bashkëautorët: *Valbona Aliko, Cristiana Roberta Multisanti, Blerta Turani and Caterina Faggio, Botuar në revistën ndërkombëtare: Sustainability 2022, 14, 11784.*<https://doi.org/10.3390/su141811784> <https://www.mdpi.com/journal/sustainability>.

Për të rritur aktivitetin e stafit akademik dhe për të tejkaluar sfidën që has kërkimi shkencor cilësor në Shqipëri. UniBa në vitin 2022-2023 ka realizuar me sukses **dy konferenca shkencore ndërkombëtare, së bashku me IEREK:**

1. "URS- Urban Regeneration and Sustainability – 13-14.12.2022"

2. "Future Smart Cities – FSC 2023 18-22.09.2023".

Në të dyja këto konferenca stafi i UniBa ka marrë pjesë me punime, duke prezantuar punime kërkimore dhe aplikative të realizuara në kuadër të projekteve ku janë pjesëmarrës, ose të realizuara në kuadër të punimeve kërkimore të realizuara gjatë procesit akademik bashkë me studentët. Të tilla si: *Digitalization and Smart Lab Concept – Msc.Sokol Shurdhi and PhD Saimir Shtylla-Urban Regeneration and Sustainability (URS) International Conference*, punim shkencor që i referohet studimit konkret që është bërë për ndërtimin e një Smart Lab në UniBa.

Pavarësisht se këto konferenca kanë shërbyer si platforma për të nxitur krijimin e punimeve shkencore nga grupe bashkautorësh brenda UniBa dhe përtej, stafi nuk ka lënë mënjanë as pjesëmarrjen në pjesëmarrjen në **konferenca brenda vendit**, si:

- *9th International scientific conference: "Advances in Business, Finance and Law", Universiteti "Aleksandër Xhuvani", Elbasan*
- *10 th international scientific conference: "Modern research and trends in economics, law and social policies". 19 November 2022, Universiteti "Aleksandër Xhuvani", Elbasan*

apo në **konferenca rajonale** si pjesëmarrje në konferencë shkencore në Gjilan, Kosovë 12 Nëntor 2022, grup autorësh, me artikullin me titull: "The role of education in choosing of



profession, career development, its management in different institutions, based on modern technology and methodology.

Ndërkohë anëtarë të stafit të UniBa janë pjesëmarrës në konferenca të ndryshme edhe si rrjedhojë e përfshirjes së tyre në grupe kërkimore përtej UniBa-s, shëmbull: *Trends in Nanotechnology International Conference (TNT2022), Tiranë 03-07 Tetor 2022, si anëtare e grupit kërkimor Nanotoxicity & Biomarkers of Effects, NanoAlb Unit, Akademia e Shkencave e Shqipërisë.*

Prezantimi i punimeve shkencore është ndër prioritetet e stafit akademik të UniBa edhe gjatë periudhës së Erasmusit:

- “Trees pollute... Do we keep planting trees”. Prezantim në takimin e organizuar nga IES Ribeira do Louro në kuadër të projektit CAREFOREST. Porrino (rajoni i Galicias)- Spanjë, 28 Qershor 2022
- “Paradigm shift in Albanian forestry: Seeing the forest beyond the trees”. Prezantim në takimin e organizuar nga IES Ribeira do Louro në kuadër të projektit CAREFOREST. Porrino (rajoni i Galicias) - Spanjë, 30 Qershor 2022

Sa i takon publikimeve, në revista me faktor impakti, artikujt/studimet variojnë në tematika të ndryshme, duke vënë theksin mbi gamën e disiplinave, programeve dhe fushave të ekspertizës, për të përmendur disa:

- [Assessing Tourism Service Trade Barrier Removal And The Dynamics On Innovation: Albania –EU](https://ijecm.co.uk/wp-content/uploads/2023/03/1136.pdf), Rezart Prifti, Albania - *International Journal of Economics, Commerce and Management, United Kingdom* <https://ijecm.co.uk/wp-content/uploads/2023/03/1136.pdf>
- *Exploring After-School Activities by Socio-Demographic Characteristics and Subjective Well-Being* 2022, by Kapllanaj, M; Sianko N, Gjedia, R, published in [Handbook of Children's Risk, Vulnerability and Quality of Life](#) pp 371–389; Springer magazine. (Scopus)
- Dobjani, E., Papa, D., (2022) *Adobe Constructions in Albania: Future Application of Earth as A Conventional Construction Material*, in *Civil Engineering and Architecture* 10(7): 3015-3027, 2022, DOI: 10.13189/cea.2022.100717 indexed by Scopus, pp. 3015 - 3027
- “Taming Randomness and Complexity – Essays in honour of Professor Peter Gacs”, Ilir Capuni, Jarkko Kari, Alexander Shen (Eds.), *the Theoretical Computer Science*, Elsevier, ISSN 0304-3975 DOI: <https://doi.org/10.1016/j.tcs.2023.113776>
- *JOURNAL OF ADVANCES IN MATHEMATICS* DOI: <https://doi.org/10.24297/jam.v22i.9374> 28/02/2023 “Applications of the ideals in the measure theory and integration” – Msc.Sokol Shurdhi
- Casari G, Dall; Ora M, Melandri A, Masciale V, Chiavelli C, Prapa M, Neri G, Prapa Spano MC, Murgia A, D&#39;Esposito A, Baschieri MC, Ceccherelli GB, Dominici M, Grisendi G. *Impact of soluble tumor necrosis factor-related apoptosis-inducing ligand*

released by engineered adipose mesenchymal stromal cells on white blood cells. *Cytotherapy*. 2023 Jun;25(6):605-614. doi: 10.1016/j.jcyt.2023.02.008;

- Neri G, Chiavelli C, Trudu L, Prapa M, Golinelli G, Pugliese G, Silingardi M, Rovesti G, Grisendi G, Bestagno M, Spano C, Benati D, Recchia A, Masciale V, Bertolini F; Dominici M Anti-GD2 CAR T Cells Against Small Cell Lung Cancer. ISCT (Paris, France) May 31-June 3, 2023 [https://doi.org/10.1016/S1465-3249\(23\)00612-6](https://doi.org/10.1016/S1465-3249(23)00612-6)

Për sa i përket avancimit në karrierën akademike, një anëtar i Departamenti të Arkitekturës dhe Dizajnit ka mbrojtur titullin Profesor i Asociuar, dy anëtar të Departamentit të Turizmit, Mikepritjes dhe Rekreacionit dhe një anëtar i Departamenti të Shkencave të Aplikuara dhe Kompjuterike kanë filluar procesin e doktoraturës.

Ndërkohë UniBa bashkëvepron në **aktivitete kërkimore me institutet** e ngritura për këtë qëllim, iniciativa të ndryshme në mbështetje të kërkimit në përgjithësi dhe projekteve të tij në vecanti. Si të tillë numërohen Adriapol, Bird, YouthAct etj. Një projekt i suksesshëm i qendrës YouthAct në këtë vit akademik ishte projekti Erasmus "Regional Youth Dialogue for Europe-RYDE" zhvilluar nga Center for Democracy Foundation (CDF). Qëllimi i projektit është të kontribuojë në forcimin e demokracisë pjesëmarrëse të integritit evropian dhe bashkëpunimit rajonal në Ballkanin Perëndimor, përmes rritjes së ndikimit të organizatave të shoqërisë civile, veçanërisht organizatave rinore në promovimin e vlerave demokratike, përfitimeve politike, ekonomike dhe sociale të Evropës. integrimin e Ballkanit Perëndimor. Staf i UniBa-s u përfshi në Shkollën Verore që u organizua në Nis të Serbisë, si aktiviteti më i rëndësishëm i projektit, në rolin e lektorit qoftë për ndarjen e ekspertizës rreth *Procesit të Integritit të EU*, qoftë për transmetimin e dijes së *Shkrimit të një Projekti*, të dy module të shkollës një javore. Dhe një pedagog dhe kërkues shkencor i UniBa vazhdon angazhimin si përgjegjës për pjesën e intervistimit me target grupin, ndjekjen e intervistave, dhe në fund raportimin e tyre.

Të tjerë shembuj të bashkëpunimeve të suksesshme që do të gjenerojnë në të ardhmen punime shkencore me impakt, duke qënë se garantojnë target grupe dhe aktivitete signifikative janë:

*“Prevention And Safe Reintegration To Violent Extremism*

- Projekti “Prevention and Safe Reintegration to Violent Extremism” në mbështetje të Institutit Adriapol
- Projekti “Shëndeti Mendor Tek Të Rinjtë” në mbështetje të Qendra YouthAct

Nga ana tjetër UniBa kontribuon në nivel kombëtar dhe rajonal apo ndërkombëtar nëpërmjet **projekteve të ndryshme të financuar nga programe ndërkombëtare.**

Në veçanti mund të përmendim draftimin e Planit të Barazisë Gjinore (*GEP-Gender Equality Plan*) si kërkesë nëpërmjet një memorandumit bashkëpunimi midis UniBa dhe AKKSHI, si partner i asociuar i projektit *Policy Answer*. Ky projekt është i financuar nga programi i kërkimit



dhe inovacionit të Bashkimit Evropian Horizon Europe sipas marrëveshjes së grantit Nr. 101058873 dhe koordinatori i tij është ZSI - Zentrum für Soziale Innovation GmbH, Vjenë, Austri. Policy Answer ka si qëllim- “Krijimin, zbatimin dhe Mbështetjen e Politikës së R&I në Ballkanin Perëndimor”, në kuadër të të cilit ofrohet shërbimi për dizajnim dhe përgatitje të Planit të Barazisë Gjinore (GeP). Komisioni Evropian vendosi barazine gjinore si një prioritet ndërsektorial dhe vendos dispozita të forcuara. Duke filluar nga viti 2022, Planet e Barazisë Gjinore (GEP) u prezantuan si një kriter i ri i përshtatshmërisë për organet publike, organizatat kërkimore dhe institucionet e arsimit të lartë për të marrë akses në financim nga Programi Kornizë Horizon Europe për Research dhe Innovation 2021-2027.

Dhe nuk mund të lihet mënjanë edhe roli aktiv i **UniBas në Edukimin e brezave të rinj** dhe afrimi i tyre me shkencën, sidomos me projektet e fushave të STEAM, siaps modeleve të përfshirjes së studentëve të së ardhmes në projekte që mund të cojnë në zhvillime inovative.

Në këtë linjë Departamenti i Shkencave të Edukimit dhe Trajnimit Profesional, ka zhvilluar:

1. “DITËT E STEAM SIPAS GJIMNAZEVE” me pjesëmarrjen e nxënësve të 12 gjimnazeve me të mëdha publike, private dhe profesionale të Tiranës ku prezantuan projektet, punimet dhe shpikjet e tyre pranë ambjenteve të Universitetit “Barleti”. Nga secili aktivitet u shpallën 3 fitues të cilët morën pjesë në NATIONAL STEAM FAIR.
2. në bashkëpunim me Departamentin e Shkencave të Aplikuara dhe Kompjuterike, panairin “TIRANA STEAM FAIR” (TSF), ku shpallën 10 fitues nga 130 pjesëmarrës-nxënës nga 40 gjimnaze dhe shkolla profesionale të vendit. Fituesit morën pjesë në konkursin ndërkombëtar TeknoFest 2023 në Stamboll-Turqi.
3. në bashkëpunim me Departamentin të Aplikuara dhe Kompjuterike edhe atë të Arkitekturës dhe Designit, Panairin “NATIONAL STEAM FAIR” (NSF), ku u shpallën 10 fitues nga 200 pjesëmarrës-nxënës nga 70 gjimnaze dhe shkolla profesionale të vendit. Fituesit do të marrin pjesë në konkursin ndërkombëtar TeknoFest 2024 në Stamboll-Turqi.

Profesionalisht stafi i UniBas kur i refrohemi Kërkimit të Aplikuar ka dhënë edhe kontribute konkrete e të prekshme si zbatimi dhe mbikqyrje të punimeve për “Qendrën e Vizitorëve” pranë Parlamentit të Shqipërisë apo Ide për qendrën e Periodikëve tek Kuvendi i Shqipërisë.

Listen e projekteve në *Aneks 8: Projekte të zbatuara dhe në proces Barleti Group.*

## V. TË DHËNA PËR GJURMIMIN E STUDENTËVE QË KANË PËRFUNDUAR STUDIMET

Për të mbështetur studentët, për të siguruar të dhëna të vazhdueshme për integrimin e tyre në tregun e punës, UniBa ka të ngritur prej vitesh Zyrën “Alumni dhe karriera”. Ajo çfarë synohet është ruajtja e lidhjeve të krijuara gjatë viteve të studimit, rivendosja e lidhjeve të vjetra ose krijimi i lidhjeve të reja. Pavarësisht nga profesioni që ata kanë zgjedhur apo synojnë të zgjedhin, studentët që diplomohen mendojnë se duhet të kthehen në universitet e tyre, se duhet




të bashkohen me ish-shokët e auditorit, ish-profesorët dhe të ndajnë të gjithë së bashku eksperiencat dhe përvojat e fituara. Universiteti “Barleti” synon ta shndërrojë zyrën e Alumni në një pikë takimi të ish- studentëve të tij, komunitetit universitar dhe botës së punës.

Nisur nga kjo, zyra e Alumni-t, vazhdon të mbajë kontakte të përhershme me të diplomuarit, ku një nga pikat e kontaktit lidhet me ecurinë e karrierës së tyre, punët e reja etj, me qëllim për t’i ndihmuar ata në promovimin e planit të karrierës në Shqipëri, si dhe të bashkëpunojë me ta për të promovuar interesa të përbashkëta.

Nga viti 2008, e deri më 2022, në Barlet janë diplomuar 3402 studentë, në ciklin bachelor dhe master. Zyra e Alumni-t, ka siguruar të dhëna për punësimin e tyre, bazuar tek komunikimet e vazhdueshme me ta, nëpërmjet adresës së e-mailit, pyetësorëve të ndryshëm të dërguar, numrave të tyre të celularit si edhe adresave të rrjeteve sociale, facebook, instagram si edhe linkedin.

Nga rezultatet e mbledhura dhe të përpunuara rezultuan se alumnit e diplomuar në Universitetin “Barleti”, nga viti 2008-2022, në programet bachelor dhe master, rezultojnë të punësuar sipas sektorëve më poshtë:



Grafik 1: Punësimi i të diplomuarëve sipas sektorëve

Pozicionet e punësimit në sektorin privat zënë një përqindje të konsiderueshme 48%, më pas vjen sektori publik me 27%, jashtë vendit 2 %, dhe biznese private 4%, profesione kryesisht si (avokat, noter, kontabilist etj). Përkatësisht, në shifra, kemi 213 alumni të cilët punojnë në bizneset e tyre private, 78 prej alumni/ae ndodhen jashtë Shqipërisë, 1896 janë të punësuar në sektor privat dhe 851 në sektor publik, ndërkohë 9 alumni janë të punësuar në sektor publik dhe privat, pjesa që mbetet rezulohet si të papunë momentalisht, 19% prej alumnaive, në një total prej 3402 të diplomuarish (bachelor dhe master).




Përsa i përket punësimëve të studentëve tanë për cdo vit akademik, nga viti 2008-2022, për programet bachelor dhe master, shohim se për **vitin akademik 2007-2008** nga 8 studentë të diplomuar në ciklin bachelor, të 8 janë të punësuar. Për **vitin akademik 2008-2009**, nga 29 të diplomuar në ciklin bachelor, kemi 27 të punësuar, 2 pa punë aktualisht dhe 1 që ndodhet jashtë Shqipërisë. Për **vitin akademik 2009-2010**, bachelor dhe master nga 359 të diplomuar (BA+MA dhe BA PT), kemi 315 alumni të punësuar aktualisht. Përsa i përket **vitit akademik 2010-2011**, nga 240 studentë të diplomuar, për programet BA+MA, kemi 192 të punësuar. Për **vitin akademik 2011-2012**, nga 164 të diplomuar në të gjitha ciklet e studimit, kemi 125 të punësuar. Për **vitin akademik 2012-2013**, për të diplomuarit në të gjitha ciklet e studimit (bachelor dhe master), nga 122 të diplomuar, kemi 93 të punësuar. Për **vitin akademik 2013-2014**, nga 78 të diplomuar, kemi 47 të punësuar. Për **vitin akademik 2014-2015**, nga 140 të diplomuar, kemi 91 të punësuar. Përsa i përket **vitit akademik 2015-2016**, për të diplomuarit në të gjitha ciklet dhe programet e studimit, nga 177 të diplomuar kemi 144 të punësuar. Për **vitin akademik 2016-2017**, për të gjitha programet dhe ciklet e studimit nga 349, kemi 294 të punësuar. Për **vitin akademik 2017-2018**, për të diplomuarit në të gjitha programet dhe ciklet e studimit, nga 299 të diplomuar, kemi një total prej 254 të punësuarish. Përsa i përket **vitit akademik 2018-2019**, nga një total prej 222 të diplomuarish, në të gjitha programet dhe ciklet e studimit, kemi 186 të punësuar. Për **vitin akademik 2019-2020**, në një total prej 423 të diplomuarish në të gjitha programet dhe ciklet e studimit, kemi 360 të punësuar. Përsa i përket **vitit akademik 2020-2021**, nga një total prej 475 të diplomuarish, 341 janë aktualisht të punësuar. Ndërsa, në të diplomuarit e **vitit akademik 2021-2022**, nga një total prej 432 të diplomuarish, kemi 318 të punësuar.

Alumni/ae e punësuar, i kemi të pasqyruar tek grafiku 1, sipas sektorëve të punësimit, përkatësisht: sektor publik, sektor privat, biznes privat, të dypunësuar në sektor publik dhe privat dhe një pjesë e vogël të papunësuar ose që ndodhen jashtë Shqipërisë. Grafiku më poshtë i pasqyron këto të dhëna edhe në përqindje.



## Numri i punesuarve sipas viteve akademike (Bachelor+Master)




Grafik 2: Punësimi 2008-2022 sipas sektorëve

Përsa i përket përqindjes së punësimit të të diplomuarve, në programet e ofruara të Universitetit “Barleti”, të cilat përgatisin për një karrierë apo profesion të caktuar, nga të dhënat e mbledhura nga Zyra e Alumni-t, respektivisht shohim se kemi të punësuar brenda profilit të studimit të ndjekur pranë Universitetit “Barlet” 1654 alumni dhe jashtë profilit të programit të studimit të ndjekur në Barlet 984 alumni, për programet bachelor dhe master, nga të dhënat të cilat janë arritur të mblidhen sa i përket profilit konkret të punës dhe vendit respektiv.




### Profili i studimit ne UniBa dhe punesimi aktual




Grafik 3: Punësimi në përputhje me profilin.

Grafiku më poshtë (grafik 4) paraqet edhe atë pjesë të alumni-t, të cilët kanë pasur ndryshime të herë pas herëshme në punë (ose kanë qënë pa punë) dhe profili i tyre i studimit në lidhje me punësimin aktual, konsiderohet si i papërcaktuar.



Grafik 4: Punësimi sipas profilit dhe ndryshimi i profilit për të diplomuarit 200-2022

Përsa i përket përqindjes së të diplomuarve që kalojnë provimin e shtetit dhe licencohen, kur programi i studimit ka lidhje me një profesion të rregulluar, më konkretisht për programet si: avokat, noter, kontabël i miratuar, mësues si edhe psikolog shohim se nga Alumni-t e Barletit, janë licencuar në total **227 alumni**, si më poshtë.



Grafik 5: Të diplomuar/licensuar sipas profesioneve.

Përkatesisht, 41 avokatë, 5 noterë, 6 kontabël të miratuar 173 mësues si edhe 2 psikologë.

Ky grup alumni, bën pjesë edhe tek alumnait të cilët kanë një biznes privat, përvec mësuesve, (kryesisht në programin edukim fizik dhe sporte).

Sa i takon të dhënave të punësimit të diplomuarëve në **vitin akademik 2021-2022**, nga një total prej 432 të diplomuarish, kemi 318 të punësuar. Më konkretisht:

Në programin Bachelor “Menaxhim biznesi”, nga 20 të diplomuar, 15 janë të punësuar në sektor privat dhe 5 pa punë aktualisht.

Në programin Bachelor “Drejtësi”, nga 14 të diplomuar, kemi 10 të punësuar në sektor privat, 1 në sektor publik dhe 3 të pa punësuar aktualisht.

Në programin “Bachelor” në “Shkenca Politike”, nga 4 të diplomuar të 4 janë aktualisht të punësuar në sektor privat.

Në programin “Bachelor” në “Edukim Fizik dhe Sporte” nga 284 të diplomuar, vetëm 34 janë të papunësuar, por mbi 22 prej tyre janë në ndryshime të herë pas herëshme të vendit të punës, duke



bërë punë sezonale. Pjesa më e madhe 65 prej tyre janë të punësuar në sektor privat, 4 punojnë tek biznesi i tyre privat dhe 24 janë të punësuar në sektor publik.

Në programin “Bachelor” në “Menaxhim në Turizëm, Rekreacion dhe Evente”, nga 2 të diplomuar të 3 janë të punësuar, ku 1 zotëron biznes privat dhe 1 i punësuar në sektor privat.

Në programin “Bachelor” në “Financë-Kontabilitet”, nga 8 të diplomuar, janë 7 të punësuar në sektor privat dhe 1 pa punë aktualisht. Burimi kyresor i informacionit është pyetësi alumni.

Në programin “Bachelor” në “Psikologji”, nga 11 të diplomuar, kemi 9 të punësuar në sektor privat dhe 2 pa punë aktualisht.

Në programin “Bachelor” në “Punë Sociale”, nga 18 të diplomuar, 8 janë të punësuar mes sektorit privat kryesisht dhe 3 në sektor publik dhe vetëm 7 janë pa punë.

Në programin “Bachelor” në “Informatikë e Aplikuar”, nga 30 të diplomuar, 20 janë të punësuar, ku 2 punojnë tek biznesi i tyre privat, 15 në sektor privat, 2 në sektor publik dhe 3 në ndryshime të herë pas herëshme të vendit të punës.

Në programin e Integruar “Master i Shkencave” në “Arkitekturë”, nga 20 të diplomuar, 15 janë të punësuar në sektor privat, 1 në sektor publik dhe 4 pa punë.


Në programin Profesional “Teknik në operator biznesi, marketing, shitje”, nga 7 të diplomuar 4 janë të punësuar në sektor privat, 1 i vetëpunësuar dhe 2 pa punë.

Në programin Profesional “Operator në fitness, palestër dhe organizim eventesh publike”, nga 8 të diplomuar 4 janë të punësuar në sektor privat dhe 4 pa punë momentalisht.

Në programin Profesional “Operator dhe këshillues në përkujdesje shëndetësore”, nga 7 të diplomuar 3 janë të punësuar në sektor privat dhe 4 pa punë.




## % E TË PUNËSUAREVE NGA TË DIPLOMUARIT NË VITIN 2021-2022



Grafik 6: Punësimi i të diplomuarëve 2021-2022

Në një total prej 432 të diplomuarish në vitin 2021-2022, 318 prej tyre janë të punësuar brenda profilit të programit të studimit që kanë ndjekur në Universitetin “Barleti”, ndërkohë 120 janë të punësuar megjithëse jo në profilin e studimit, 6 ndodhen jashtë vendit dhe pjesa që mbeten janë në ndryshime të herë pas herëshme të vendit/pozicionit të punës, janë pa punë dhe/ose në praktikën profesionale të paguar pas masterit (për profesione si mësues).

Theksojmë këtu se të diplomuarit e vitit 2022, kanë vetëm 1 vit që kanë mbaruar studimet dhe gjetja e një pune në profesion (sidomos për profesionet e rregulluara) kërkon më shumë kohë.




Grafik 7: Punësimi i të diplomuarëve 2021-2022 sipas sektorëve

Pjesa më e madhe e të punësuarëve janë duke punuar në sektorin privat, i cili zë 69% të të punësuarëve, përkatësisht 287 alumni. Në sektorin publik kemi të punësuar 111 alumni, 10 janë të vetëpunësuar në bizneset e tyre private dhe një përqindje e vogël (6 alumni) ndodhen jashtë vendit. Pjesa që mbetet janë duke ndjekur praktikën profesionale të punës, të pa punë ose në ndryshime të vendit të punës.

Nisur nga fakti se të diplomuarit e vitit 2021-2022, kanë vetëm 1 vit që kanë përfunduar studimet, asnjë prej tyre nuk është licencuar (për profesione që zhvillimi profesional i karrierës parashikon edhe mbrotjen e një provimi shtetëror për të fituar një titull të caktuar), megjithatë, një pjesë prej tyre pritet që të licencohen brenda muajve në vijim.

P.sh 3 studentë alumni përfundojnë në fund të muajit korrik 2023 shkollën e avokatisë (shkollë 1 vjecare) dhe mbrojnë licencën e tyre rreth muajve tetor-nëntor 2023, kjo vlen edhe për mësuesit të cilët presin të mbrojnë provimin e shtetit.

Nga komunikimet me ta, synimet për t'u licencuar janë të konsiderueshme, por për këtë iu duhen disa vite eksperiencë pune dhe më pas konfigurimet përkatëse.



**Grafik 8: Burimi i informacionit**

Përsa i përket burimit të informacionit, zyra “Alumni dhe Karriera”, ka marrë informacion lidhur me punësimet e të diplomuarëve kryesisht nëpërmjet telefonatave me ta, përkatësisht 364 alumni i janë përgjigjur thirtjes telefonike, 35 i janë përgjigjur pyetësorit alumni, 7 janë përgjigjur në e-mail, 33 janë kontaktuar nga rrjetet sociale si edhe LinkedIn dhe 27 nëpërmjet njohjeve nga stafi (pedagogët, përgjegjësja e zyrës “Alumni” etj).



Zyra “Alumni dhe Karriera”, përveç kontaktimit me të diplomuarit lidhur me punësimin e tyre, zhvillon aktivitete të përmuajshme me ta, nisur nga kjo është reaktivisht e lehtë për Universitetin Barleti dhe zyrën “Alumni” që të komunikojë vazhdimisht me të diplomuarit dhe forcojë kontaktet me ta si ambasadorët më të mirë të UniBa.

## **VI. TË DHËNA PËR KËSHILLAT STUDENTORË DHE PËRFAQËSIMIN E TYRE NË ORGANET DREJTUESE TË IAL-SË DHE NË NJËSINË E SIGURIMIT TË BRENDSHËM TË CILËSISË.**

UniBa ka një strukturë të veçantë të emërtuar si Dekani i studentëve. Zyra e Dekanit të Studentëve promovon rritjen akademike të studentëve dhe kultivimin e parimeve të qytetarisë përmes krijimit të klimës pozitive dhe ndërvepruese në Universitetin “Barleti”. Dekani i studentëve kontribuon që studentët të arrijnë suksesin e tyre përmes mbështetjes dhe fuqizimit të bashkëveprimit midis studentëve dhe stafit akademik e administrativ, nxitjes së mendimit kritik, mbështetjes së ideve sipërmarrëse, inovative dhe artistike. Dekani i Studentëve është mbështetja e parë në çdo aktivitet që organizojnë Barletasit, brenda dhe jashtë kampuseve. Misioni i këtyre aktiviteteve është të pasurojnë zhvillimin intelektual, etik dhe social të studentëve në UniBa, duke i angazhuar ata më shumë në komunitet si dhe duke nxitur e zhvilluar shprehje dhe aftësi drejtuese e organizative.

**Një aspekt i rëndësishëm i mbështetjes së studentëve është nxitja e tyre në organizimin e qeverisë studentore, përfaqësimin në struktura si Senat, Komisionet e përhershme.**

Bazuar në ligjin nr. 80 datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në IAL në Republikën e Shqipërisë” neni 99, Statutit të Universitetit “Barleti”, Rregullores për organizimin e zgjedhjeve të Senatit Akademik në UniBa, Neni 4, zhvillohen zgjedhjet për Qeverinë Studentore.

Zgjedhjet për Qeverinë Studentore në UniBA janë periodike dhe zhvillohen çdo dy vite.

- Zgjedhjet bëhen me votim të lirë, të fshehtë, të barabartë dhe të drejtëpërdrejtë, sipas rregullave të parashikuara në këtë rregullore. Zgjedhësit e ushtrojnë lirisht të drejtën e votës.
- Çdo zgjedhës ka të drejtën e një vote të vetme për kandidatët në Qeverinë Studentore.
- Një kandidat mund të konkurojë vetëm për një vend në Qeverinë Studentore.
- Çdo kandidat ka të drejtë të organizojë dhe zhvillojë aktivitete për paraqitjen e programit të tij duke mos cënuar procesin mësimor.
- Shpallet i zgjedhur si anëtar i Qeverisë Studentore kandidati që fiton numrin më të madh të votave të vlefshme të zgjedhësve që marrin pjesë në votim, me përjashtim të kandidatëve të vetëm.

<sup>3</sup> <https://umb.edu.al/zyra-e-karrieres-dhe-alumni.html> link në web ku pasqyrohen takimet dhe aktivitetet e përmuajshme me Alumni





- Kur kandidon një kandidat i vetëm, ky i fundit shpallet fitues me jo më pak se 50 për qind plus një të votave të vlefshme.
- Në rast se për vendin e anëtarit të Qeverisë Studentore nuk regjistrohet ose nuk fiton asnjë kandidat, zgjedhjet për këtë vend zhvillohen me urdhër të Rektorit, jo më parë se 3 muaj nga data e zgjedhjeve të shpalluara.

Dekani i studentëve mbështet vetqeverisjen e studentëve. Qeveria e Studentëve e përbërë nga secili senator i çdo viti dhe programi studimi promovon, koordinon dhe inkurajon pjesëmarrjen e studentëve dhe përfaqësimin e ideve e opinioneve të tyre në organet drejtuese të Universitetit, në strukturat mësimore-kërkimore dhe synon garantimin e shërbimeve si: Funkcionimin e Klubeve Studentore; Shërbimeve dhe Aktiviteteve Sociale; Përmirësimin e jetës në kampus.

Në zbatim të Statutit të UniBa-s, Neni 20, Pika 2/e, çdo fakultet përfaqësohet në Senatin Akademik, me 1 student, që del fitues nga procesi votimit. Zgjedhjet zhvillohen çdo dy vite.

Studentët përfaqësohen edhe në Këshillin e Etikës, Komisionin e sigurimit të Cilësisë. Propozimi vjen nga qeveria studentore. Gjithashtu në të gjitha Grupet e Vlerësimit të Brendshëm ka përfaqësues të studentëve, nga programet përkatëse.

***Për vitin akademik 2022-2023*** gjatë muajit tetor 2022 u zhvilluan zgjedhjet për senator për ata programet studimi ku u paraqitën kërkesa nga vetë senatori paraardhës ose studentët për zëvendësim. Gjatë muajit nëntor u zhvilluan zgjedhjet për senator për vitet e para. Për më shumë se 3 javë, Dekani i Studentëve është përfshirë në njoftimin e studentëve për të zgjedhur senatorët për çdo program. Studentët paraqitën kërkesat e tyre si kandidatë të mundshëm për senator dhe pas kësaj date u zhvilluan zgjedhjet brenda çdo grupi.

Kriteret e përzgjedhjes për këtë status janë: studentë të nivelit të lartë akademik; Frekuentues i rregullt në procesin mësimor; Aftësi të mira komunikimi ku të shprehë entuziazmin e tij/saj; Sjellje korrekte dhe profesionale kur përfaqëson Universitetin "Barleti".

Senatorët e përzgjedhur për vitin akademik 2022-2023 janë të prezantuar edhe në web-in e Uniba: <https://students.umb.edu.al/qeveria-studentore.html>

Qeveria e Studentëve e përbërë nga secili senator i çdo viti dhe programi studimi promovon, koordinon dhe inkurajon pjesëmarrjen e studentëve dhe përfaqësimin e ideve e opinioneve të tyre në organet drejtuese të Universitetit, në strukturat mësimore-kërkimore dhe synon garantimin e shërbimeve si: Funkcionimin e Klubeve Studentore; Shërbimeve dhe Aktiviteteve Sociale; Përmirësimin e jetës në kampus.





*Sa i takon Proçesit të zgjedhjeve të studentëve për përfaqësues në Senatin Akademik, Në zbatim të Statutit të UniBa-s, Neni 20, Pika 2/e, çdo fakultet përfaqësohet në Senatin Akademik, me 1 student, që del fitues nga procesi votimit. Zgjedhjet zhvillohen çdo dy vite.*

Periodha e regjistrimit të kandidatëve ishte gjatë intervalit kohor 14-18.11.2022 në përputhje me Nenin 4, Pika 4, të "Rregullores për organizimin e zgjedhjeve për Senatin Akademik në UniBa".

Sipas Urdhërit të Rektores, Nr. 13/1, date 31.10.2022 "Për organizimin e procesit të zgjedhjeve studentore për Senatin Akademik të Universitetit "Barleti", zgjedhjet u zhvilluan me datë 01.12.2022 me komision të përbërë nga Zv.Rektori për Çështjet Studentore dhe Komunitetin, Juristë, Dekani i studentëve dhe shtatë studentë.

Pas zgjedhjeve rezultuan këta studentë si anëtar të Senatit: për Fakulteti i Ekonomisë, Qeverisjes dhe Drejtësisë -S.B- Marketing, Publicitet dhe Marrëdhënie me publikun, viti 1; Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Industrive Kreative – F. A, Informatikë e Aplikuar, viti 2; Fakulteti i Shkencave Sociale, Turizmit dhe Sportit F. Rr. Edukim Fizik dhe Sporte, viti 2; Fakulteti i Shkencave Mjekësore A. I. - Farmaci, viti 1.

Sa i takon pjesmarrjes në komisionet e përhershme të parashikuara në ligjin e arsimit të lartë, studentët përfaqësohen me studenten K.B. në Këshillin e etikës dhe shanseve të barabarta, kjo sipas Vendimit të Senatit nr.34 datë 24.11.2022 "Mbi miratimin e Këshillit të Etikës dhe Shanseve të Barabarta", si dhe me studenten A.D. në Komisioni e sigurimit të standardeve dhe Cilësisë, bazuar në Vendimin e Senatit nr.9 datë 28.03.2023 "Për miratimin e Komisionit të Sigurimit të Standardeve dhe Cilësisë".

## **VII. TË DHËNA MBI STRUKTURËN E PËRGJITHSHME**

### **7.1. Të dhëna mbi strukturën e përgjithshme.**

Mirëfunktionimi dhe administrimi i UniBa mbështetet nga një sërë strukturash, për të asistuar sa më profesionalisht studentët, për të lidhur sa më mirë njohuritë akademike me ato praktike institucioni ka disa njësi dhe institucione në funksion të këtyre qëllimeve si Administratori, Zyra e Shërbimeve Mbështetëse, Zyra e Financës, Zyra Ligjore etj. Ndërkohë që sekretaria, laboratorët, biblioteka, shërbimet studentore janë tashmë struktura të konsoliduara në UniBa.

UniBa disponon dokumentacion të plotë të veprimtarisë akademike në hard copy dhe formë elektronike. Zyra e Protokoll Arkivës, mban në format hard copy dhe elektronik, dokumentacionin ligjor hyrës dhe dalës nga institucioni, aktet rregullatore të brendshme, urdhrat e udhëzimet organeve dhe autoriteteve vendimmarrëse të UniBa. Departamentet administrojnë në format hard copy dhe elektronik, programet mësimore, procesverbalet e mbledhjeve të departamentit. UniBa disponon databazë për regjistrimin e studentëve, nr. e matrikullimit, të







dhëna lidhur me historikun dhe ecurinë e studimit të studentëve dhe dosjet përkatëse, të cilat administrohen nga sekretaria.

Sekretaria mësimore ruan dokumentacionin e vlerësimit për çdo modul/lëndë, regjistrat, dosjet e studentit, mban dhe përpunon statistika mbi numrin e studentëve për profil, kalueshmërinë, notat mesatare të çdo studenti. Kryesekretari përgatit për vendimmarrje dokumentacionin për aplikimin, regjistrimin, ndërprejjen apo rifillimin e studimeve si dhe të transferimit; Është përgjegjës për plotësimin e dokumentacionit, pranimin dhe lëshimin e vërtetimeve, certifikatave dhe dokumenteve të tjera. Nxjerr dhe përgatit në kohë të dhëna mbi rezultatet e studentëve, numrin e tyre sipas viteve e degëve si dhe për realizimin e ngarkesave mësimore nga ana e personelit akademik, me kërkesën e drejtuesve akademikë e administrativë të institucionit.

Sekretaria mësimore ka një regjistër me të dhënat personale të studentëve dhe i përpunon ato në përputhje me aktet ligjore, sikundër edhe regjistra të arritjeve akademike për çdo program studimi. Kryesekretari kujdeset për garantimin e procesit të rregullt të mbajtjes së të dhënave personale dhe për përmbajtjen e regjistrave. Regjistrat e studentëve janë dokumente të rezervuar. Të drejtën për të administruar regjistrat e studentëve e ka vetëm kryesekretari i UniBa. Sekretaria e UniBa ka një regjistër të përhershëm të studentëve (në formë të shkruar dhe elektronike) me vlerësimet e marra gjatë ndjekjes së programit të studimit, të dhëna mbi diplomën ose diplomat e marra, bashkë me suplementin. Në dokumentacionin që ruan dhe administron sekretaria mësimore ruhen dhe pasqyrohen edhe të dhëna që lidhen me ndryshimet, arritjet e studentit gjatë studimeve. Të drejtën e administrimit të të dhënave e ka sekretaria, ndërsa njohjen me përmbajtjen e tyre, pa autorizimin e studentit, e kanë vetëm Dekani i Fakultetit dhe Përgjegjësi i Departamentit.

## 7.2. Të dhëna mbi planin buxhetor

Zbatimi i politikave financiare në UniBa bëhet nga Zyra e financës, e cila është përgjegjëse për respektimin e parimeve dhe rregullave të kontabilitetit në përputhje me aktet ligjore. UniBa mban në llogaritë e saj aktivet, pasivet dhe transaksionet. Pasqyrat Financiare hartohen të qarta për përdorues të jashtëm dhe sigurojnë besueshmëri sepse në to nuk ka gabime materiale dhe respektohen parimet e besnikërisë, të përmbajtjes ekonomike ligjore, paanshmërisë, plotësisë, duke dhënë pamje të vërtetë të pasqyrave financiare, të qëndrueshmërisë dhe krahasueshmërisë parashikuar edhe në aktet ligjore. Për menaxhimin financiar dhe kontrollin, UniBa, në zbatim të ligjit, ka ndërtuar e vendosur sistemin e politikave procedurave, veprimtarive dhe kontrolleve. Çdo vit treguesit financiarë si dhe zbatimi i buxhetit bëhen pjesë e analizës në Bordin e Administrimit.

UniBa, harton buxhetin në përputhje me procedurat e përcaktuara, bazuar në legjislacionin në fuqi. Hartimi i plan-buxhetit bëhet sipas udhëzimeve të Ministrisë së Financave. Procedurat, kompetencat dhe autoritetet mbi hartimin e buxhetit janë të përcaktuara qartë në aktet e brendshme rregullatore. Senati Akademik i propozon Rektoratit kërkesat buxhetore për vitin



pasardhës në përputhje me Strategjinë e zhvillimit afatmesëm. Rektorati i propozon Bordit të Administrimit përmes Administratorit projekt buxhetin një vjeçar në përputhje me strategjinë afatmesme të institucionit. Bordi i Administrimit me propozim të Senatit, miraton buxhetin vjetor dhe atë afatmesëm të institucionit dhe mbikëqyr zbatimin e tyre. Administratori i UniBa drejton, ndjek dhe kontrollon zbatimin e buxhetit vjetor dhe veprimtarive financiare të institucionit dhe në të gjitha strukturat e varësisë së tij.

Kontrolli buxhetor e financiar realizohet nëpërmjet auditeve të brendshëm e të jashtëm. Nëpërmjet akteve të brendshme administrative, politikave, udhëzimeve dhe rregulloreve, UniBa siguron zbatimin e ligjshmërisë për kontrollin e brendshëm. Bilanci dhe pasqyrat financiare, krahas kontrollit të brendshëm, i nënshtrohen rregullisht çdo periudhe ushtrimore kalendarike vjetore, auditimit financiar nga kompani auditimi ndërkombëtare, të regjistruar në Shqipëri (kompania Grant Thornton shpk), sipas parashikimit në ligj. Po kështu edhe kontrolleve nga ekspertë tatimorë të Drejtorisë së Tatim Taksave. Raporti i veprimtarisë financiare bëhet i njohur në mbledhjen e senatit.

Zyra e Financës nën drejtimin e Administratorit, hartojnë çdo vit raportet me të dhëna të hollësishme, financiare të kostove për realizimin e programeve të studimeve, si dhe të veprimtarive që lidhen me kërkimin shkencor dhe kualifikimin e personelit dhe mbi bazën e tyre bëhen parashikime për periudha afatmesme.

Nga pasqyrat financiare ndër vite, raportet e auditimit, opinionet dhe sugjerimet e Bordit, rezultojnë se institucioni ka qëndrueshmëri financiare dhe kapacitetet financiare të duhura për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave në të ardhmen. Raporti i auditimit financiar evidenton përdorimin e të ardhurave nga tarifat e studentëve në favor të rritjes së cilësisë së mësimdhënies dhe shërbimeve për studentët. Kjo evidentohet qartë edhe në plane e biznesit me investime të konsiderueshme ndër vite në infrastrukturë dhe pajisje teknologjike dhe IT. Investimet për këto të fundit bëhen çdo vit, sipas kërkesave.

Referuar bilancit të kompanisë, rezultojnë se kompania ka qëndrueshmëri financiare. UniBa ka procedurë të qarta dhe transparente në lidhje me tarifat e studimit (**Aneks 9: Vendimi i Bordit të Administrimit nr. 38 datë 20.02.2023**); siç e përmendëm më lart ka një qëndrueshmëri financiare dhe kjo falë edhe parashikimeve të kujdesshme dhe menaxhimit të mirë të financave, kjo shihet lehtësisht në bilancet e shoqërisë ndër vite (**Aneks 10: Buxheti dhe parashikimi ndër vite**); shlyen rregullisht të gjitha detyrimet (**Aneks 11: Vërtetim pagese detyrimesh**), dhe garanton me qëndrueshmërinë e saj financiare ecurinë e mëtejshme dhe besueshmërinë e publikut.

Në raportet e kompanisë audituese konstatohet se pasqyrat financiare vjetore të UniBa janë të rregullta në pajtueshmëri me parimet kryesore të përcaktuara në ligj. UniBa zbaton politika të

qarta të përdorimit buxhetor, menaxhon dhe ka evidencë të pasurive të paluajtshme. (*Aneks 12: Raporti i auditit të pavarur viti 2022*)

### 7.3. Të dhëna mbi studentët

Në vitin akademik 2022-2023 rezultojnë në total të regjistruar 1718 studentë. 35 të regjistruar në programe profesionale dyvjeçare, 992 në programet bachelor, 348 studentë të regjistruar në programe master profesional, 174 studentë në programe master i shkencave dhe 169 në program i integruar i ciklit të dytë master i shkencave. Në programet profesionale dyvjeçare, bachelor dhe programe të integruar master i shkencave rezultojnë 46 të ç'rregjistruar, në programet master 7. Arsytet janë të ndryshme si për arsye të largimit nga Shqipëria, për shkak të pamundësive ekonomike, arsye shëndetësore etj. Të dhënat në lidhje me kalueshmërinë dhe numrin e studentëve sipas programeve pasqyrohen në (*Aneks 13: Të dhëna mbi numrin e studentëve sipas programeve, viteve, kalueshmërisë, ç'regjistrimet*).

Në kuadër të marrëveshjeve Erasmus + ka mundësuar mobilitetin e 7 grupeve/10 studentëve të UniBa-s dhe ka mirëpritur 2 grupe 4 studentë nga universitetet partnere. Informacioni përkatës pasqyrohet në *Aneks 14: Mobiliteti i studentëve në kuadër të projekteve Erasmus+*.

### 7.4. Të dhëna mbi plotësimin e standardeve shtetërore

UniBa për shkak të aplikimit për programe të reja, por dhe sipas procedurave të parashikuara për miratimin e kuotave të studimit, ka paraqitur pranë MAS dokumentacionit përkatës në lidhje me infrastrukturën dhe standardet, të cilat janë në përputhje me kërkesat. Edhe këtë vit akademik, kuotat janë miratuar pikërisht në përputhje me standardet e parashikuara dhe të verifikuara nga ekipi i miratuar nga Ministri i MAS.

Çdo vit në varësi të nevojave, bëhen përmirësimet, investimet përkatëse në infrastrukturë, veçanërisht për programet e reja, siç janë ato të lidhura me laboratorët e mjekësisë, stomatologjisë etj.

Nëse e shohim pak më të shtriturë në kohë mund të themi se rritja dhe zhvillimi i UniBa ka ardhur në mënyrë të natyrshme që nga viti 2005 i themelimit. Kampus 1 vënë në funksion në fillimin e themelimit të universitetit është rikonstruktuar për herë të fundit në vitin 2019, dhe përshtatje mjedisesh gjatë verës së këtij viti. Në 2010, UniBa rriti investimet në infrastrukturë me ngritjen e Kampusit 2. Po në funksion të rritjes dhe zhvillimit strategjik në 2019 nisi punën për ndërtimin e një kampusi tërësisht të ri me infrastrukturë bashkëkohore. Kontrollat e ushtruara nga autoritetet shtetërore konstatuan se ndërtimet e UniBa janë kryer në përputhje me kushtet teknike, ligjore, materiale cilësore, të sigurta dhe në përputhje me normat higjieno-sanitare.



Kampuset janë të pozicionuara larg zonave industriale, sigurojnë mjedise të qeta, me akustikë brenda normave, ndërsa rikonstruktionet kanë përdorur elemente izoluese ndaj zhurmave dhe lagështirës. Në kampusin 2, temperatura konstante sigurohet nga një sistem qëndror i kondicionimit dhe ajrimit HVAC. UniBa ka mjediset e nevojshme për auditorë mësimi; mjedise laborator; mjedise teknike, salla studimi dhe bibliotekë, salla konferencash; mjedise pushimi, veranda të hapura, bar restorant për stafin dhe studentët, nyje higjieno sanitare në çdo kat dhe të ndara; co-working space; meeting room; creative city; laboratorët për IT-në, elektronikën, biologji kimi; multimedia; palestër force, palestër stërvitjeje, dhoma të zhveshjes; salla e fizioterapisë.

UniBa për lëndët dhe programet e IT dhe Arkitekturës ka infrastrukturë të përshtatshme teknologjike ku janë instaluar sisteme operative si Windows XP; Software: MySql, Java. BlueJ, Microsoft Visual Studio, SPSS, XAMPP, AutoCad, PhotoShop, Revit. Janë krijuar të gjitha ambientet e laboratorit të Informatikës dhe Arkitekturës, ambiente për ofrimin e kurseve të eficientës së energjisë, vlerësimit të pasurive të paluajtshme, interior design, restaurime.

Lartësia e mjediseve, referuar dhe planimetrisë, është mbi 3.0 m, konform standardeve. Kushtet teknike të ndriçimit natyral në mjediset mësimore përmbushen pasi mbi 20% e sipërfaqes së dyshemesë dritare. Në kampusin e ri kushtet teknike të ndriçimit natyral në mjediset mësimore plotësohen mbi 30% të sipërfaqes së dyshemesë, dritare. Në të 2 kampuset dhe godinë re ekzistojnë dalje dhe shkallë emergjence që plotësojnë standardet e sigurisë. Institucioni ka në të dy kampuset gjenerator dhe depozita, duke siguruar 24 orë energji elektrike dhe ujë.

## VIII.KONKLUZIONE

UniBa edhe këtë vit në vlerësimin e përgjithshëm mund të themi se i ka përmbushur objektivat. Gjatë këtij viti institucioni iu nështrua kontrollit të ligjshmërisë, dhe bazuar në draft raportin e ardhur nga MAS (prietet raporti përfundimtar) do të organizojë punën për përmirësimin e aspekteve të rekomanduara, por të cilat në thelb nuk prekin funksionimin e mirë dhe cilësor të institucionit.

UniBa është i mirë organizuar në përputhje me aktet ligjore në fuqi. Dokumentacioni i plotë, ligjor dhe menaxherial, funksionimi i frytshëm i organizmave drejtues dhe njërive të saj strukturore, dëshmon rrugën e suksesshme që nga viti 2005, pasi institucioni është udhëhequr nga strategji, vizione dhe objektiva të planifikuara dhe të zbatuara në mënyrë efektive.

UniBa reflekton kulturë komunikimi me institucionet e linjës vertikale dhe horizontale si dhe brenda institucionit dhe jashtë tij me partnerë apo struktura ku raporon apo nga të cilat





kontrollohet apo parashikuar nga legjislacioni si struktura bashkëpunuese si MAS, QSHA, RASH, ASCAL.

Kurrikulat, programet e reja apo të përshtatura në përputhje me zhvillimet e tregut janë një aspekt për t'u vlerësuar. UniBa ka një kurrikul të gjerë, që programet profesionale dyvjeçare, bachelor, programe të integruara master i shkencave, master profesional dhe master i shkencave, dhe të gjitha janë konform legjislacionit në fuqi, objektiveve të reformës së arsimit të lartë dhe procesit të Bolonjës. Përmbajtja shkencore, metodologjike, çështjet e vlerësimit të kurrikulës janë në koherencë me përvojat më të mira, bashkëkohore. Programet e studimit janë të një cilësie të lartë dhe garantojnë përgatitjen e studentëve dhe për tregun e punës.

UniBa, një institucion që ka njohur rritjen graduale dhe të qëndrueshme në strukturë e ofertë akademike, zhvillon procese të kërkimit shkencor nëpërmjet departamenteve, pedagogëve dhe njësive e strukturave të grupit Barleti, duke gjeneruar veprimtarinë kërkimore, me struktura që krijojnë fleksibilitet dhe përshtatshmëri me kërkesat dhe nevojat e tregut duke i dhënë institucionit një karakter dinamik dhe inovator. Projektet dhe veprimtaritë e mundësuar me institutet kërkimore të themeluara nga UniBa apo Grupi Barleti paraqesin një qasje të kërkimit aplikativ duke theksuar veprimtari të tilla si Bootcamp-et.

Partneriteti me institucione publike dhe private, kombëtare dhe ndërkombëtare mbetet një pikë e fortë e ofrimit të një shërbimi cilësor. Siç nënvizohet në raport implementimi i marrëveshjeve, mobiliteti bazuar në marrëveshjet Erasmus +, nënshkrimi i marrëveshjeve të reja me partnerë të rinj në funksion të mësimdhënies, praktikave, workshop-eve, konferencave pasqyron qartë rëndësinë që merr një bashkëpunim i tillë. Përbërja e stafit me pedagogë të kualifikuar dhe doktoruar në universitete perëndimore ose nga personalitete akademike në vend, përtëritja e tyre e vijueshme, zhvillimi i veprimtarive për zhvillimin profesional të personelit kanë krijuar siguri institucionale.

Menaxhimi financiar bëhet në mënyrë transparente, në përputhje me aktet ligjore dhe zbatohen politika të kontrollit buxhetor. Bazuar në pasqyrat financiare tregon qëndrueshmëri në të ardhurat e realizuar që nga krijimi.

UniBa ka në objektivat si afatshkrutra edhe ato afatgjatë përmirësimin e infrastrukturës dhe kjo ka ndikuar pozitivisht në rezultatet e të nxënit dhe vlerësimin që kanë studentët aktualë për UniBa. Mjediset e kampuseve, cilësia ndërtimore, teknologjia e instaluar, shërbimet



mbështetëse, bibliotekat funksionale dhe ato on-line, burimet materiale dhe didaktike, mjediset e siguruara nga marrëveshjet, janë mbështetje e mbarëvajtjes së procesit mësimor.

Shtrirja e ofertës akademike në programe të formimit të vazhduar si ato për auditues, menaxherë energjistik, vlerësues të pasurive të paluajtshme, akreditimi i moduleve trajnuese për mësuesit, organizimi i Shkollës së Drejtorëve për të katërtin vit, tregojnë për një përshtatje, pasurim të ofertës akademike dhe kapaciteteve akademike dhe infrastrukture.

UniBa zhvillon në vijimësi projekte dhe aktivitete shkencore me partnerë vendas dhe të huaj, duke mundësuar mobilitetin ndërkombëtar të studentëve dhe të pedagogëve të saj, në rritje gjatë dekadës së fundit. Vetëm këtë vit akademik është mundësuar mobiliteti për 19 grupe me 52 anëtarëve të atafit të UniBa në universitet partnerë të Erasmus +, ka mirëpritur 11 grupe ose 23 individëve të stafeve nga universitetet partnerë, ka mundësuar mobilitetin 10 studentëve të UniBa-s si dhe ka mirëpritur 4 studentë nga universitetet partnerë.

Institucioni zbaton politika për informimin, këshillimin, rekrutimin dhe punësimin e studentëve. UniBa ruan dhe përditëson të dhënat e punësimit të studentëve çdo vit akademik.

#### **IX. VLERËSIMI I PËRGJITHSHËM I KOMUNIKIMIT ME MAS**

Komunikimi me MAS kanë qenë në mënyrë të vazhduar. Gjithashtu për shkak të legjislacionit dhe mënyrës së funksionimit komunikimi ka qenë efektiv edhe me QSHA. Institucioni ka mirëpritur grupet e punës si për kontrollin e ligjshmërisë, edhe për vlerësimin e kapaciteteve, sikundër edhe mendimet, rekomandimet e tyre.

Një problematikë që është hasur, është ajo e pajisjes me regjistra nga QSHA. Akoma nuk kemi marrë të gjithë regjistrat e kërkuar.

Gjithashtu siç pasqyrohet në raport, UniBa aplikoi për një numër të konsiderueshëm programesh të reja, dhe vlerësimi, argumentimi nga MAS si në rastin e miratimit por edhe në rast të refuzimit të disa prej tyre vlerësohet nga institucioni.

**Rektori**

**Prof. Dr. Suzana GUXHOLLI**


**Administratori**

**Adriatik DUDAJ**


38